



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 78

Tiranë – E enjte, 30 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 48/2020 datë 23.4.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës në lidhje me themelimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, të <i>Proparco</i> dhe të <i>Expertise France</i> në Shqipëri 4357
Dekret i Presidentit nr. 11468, datë 29.4.2020	Për shpallje ligji..... 4363
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 7, datë 21.4.2020	Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit për produktet bujqësore dhe ushqimore me tregues specialitet tradicional i garantuar..... 4363
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 141, datë 16.4.2020	Për miratimin e rregullores mbi parashtrimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operationale në lidhje me lundrimin ajror në bazë të performancës..... 4366
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 255, datë 10.4.2020	Për disa nryshime në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”..... 4370
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 256, datë 10.4.2020	Për disa shtesa dhe nryshime në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar..... 4370
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 257, datë 10.4.2020	Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike..... 4371
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 263, datë 17.4.2020	Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor, dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private..... 4384

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 263/1, datë 18.4.2020	Për disa shtesa në urdhrin nr. 263, datë 17.4.2020, “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen me mjete private”.....	4384
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 273, datë 24.4.2020	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 263, datë 17.4.2020, “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private”.....	4385
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 278, datë 25.4.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4385
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 279, datë 25.4.2020	Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e gjelbërta”.....	4386
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 24.3.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.....	4387
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 24.3.2020	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, seria t15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015.....	4388
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 26.3.2020	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., nr. 290, seria t15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 72, datë 13.5.2015.....	4390
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 26.3.2020	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq energy Albania” sh.p.k., nr. 291, seria fk15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 73, datë 13.5.2015.....	4392
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 26.3.2020	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 141, datë 24.9.2019, mbi licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	4394
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 26.3.2020	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 142, datë 24.9.2019, për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	4395
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 26.3.2020	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 228, datë 26.10.2018, për licencimin e shoqërisë “OSOJA HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoje” me kapacitet të instaluar 1952 kw, në zonën e Moglicës –Korçë (lumi Osojë).....	4396

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë
nr. 57, datë 26.3.2020

Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë
10.5.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SMART WATT’ sh.p.k., në
veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali
fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën Sheq
Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier”.....

4397



LIGJ
Nr. 48/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË FRANCËS NË LIDHJE
ME THEMELIMIN DHE USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË AGJENCISË
FRANCEZE TË ZHVILLIMIT, TË
PROPARCO DHE TË EXPERTISE
FRANCE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës në lidhje me themelimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, të *Propano* dhe të *Expertise France* në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11468, datë 29.4.2020
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Illir Meta

MARRËVESHJE
MIDIS KISHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
FRANCËS NË LIDHJE ME
THEMELIMIN DHE USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË AGJENCISË
FRANCEZE TË ZHVILLIMIT, TË
PROPARCO DHE TË EXPERTISE
FRANCE NË SHQIPËRI

Këshilli i Ministrave i Republikës Së Shqipërisë
Dhe

Qeveria E Republikës Së Francës,

Të quajtura në vijim, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, “Palët”;

Duke kujtuar që Shqipëria dhe Franca udhëhiqen nga dëshira për të forcuar lidhjet e tyre të miqësisë dhe të bashkëpunimit;

Duke shprehur kënaqësinë për vullnetin e tyre të përbashkët për intensifikimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe financiar midis të dyja vendeve;

Duke pranuar që Agjencia Franceze e Zhvillimit (në vijim e quajtur “AFD”) dhe filiali i saj i specializuar në financimin e zhvillimit të sektorit privat, Shoqëria e Promovimit dhe e Pjesëmarrjes për Bashkëpunimin Ekonomik (në vijim e quajtur “Propano”), që formojnë grupin ADF (në vijim i quajtur “Grupi AFD”), si dhe Agjencia franceze e ekspertizës teknike ndërkombëtare, e specializuar në promovimin e asistencës teknike dhe të ekspertizës ndërkombëtare publike franceze jashtë shtetit (në vijim e quajtur “Expertise France”), zhvillojnë veprimtaritë e tyre në territorin e Shqipërisë;

Duke kujtuar, nga njëra anë që Grupi AFD është pjesë qendrore e strukturës franceze të ndihmës publike në favor të vendeve në zhvillim dhe që ushtron veprimtaritë e tij në mbi 80 vende, në sajë të një rrjeti prej rreth gjashtëdhjetë përfaqësish vendore;

Dhe, nga ana tjetër, që *Expertise France* është operatori i shtetit francez në fushën e bashkëpunimit teknik ndërkombëtar dhe kontribuon në plotësim të aktivitetit të grupit AFD, për realizimin e objektivave të solidaritetit ndërkombëtar dhe politikën e zhvillimit të Francës;

Duke kujtuar se AFD, si institucion publik, industrial dhe tregtar:



- lufton kundër varfërisë, mbështet rritjen ekonomike dhe merr pjesë në ruajtjen e pasurive publike botërore në vendet në zhvillim, vendet emergjente dhe territoret franceze të përtej-detit;

- e vendosur nën tutelën e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të Ministrisë së Përtej Detit dhe të Ministrisë së Brendshme, vë në jetë politikën franceze të ndihmës për zhvillim dhe vepron nën kontrollin e këtyre ministrive dhe në bashkëpunim të ngushtë me to;

- ndërhyt kryesisht në kuadrin e programit të investimeve prioritare të shtetit pritës përmes subvencioneve, huave afatgjata dhe garancive të dhëna shtetit, bashkësive vendore dhe ndërmarrjeve e institucioneve financiare publike ose private, ose në kuadrin e pjesëmarrjeve në ndërmarrjet që operojnë në zonat e ndërhyrjes së saj;

- propozon gjithashtu shërbime konsulence, trajnimi dhe asistencë teknike;

Duke kujtuar se *Proparco*, e krijuar në vitin 1977 në formën e një shoqërie të së drejtës franceze:

- është një institucion financiar i zhvillimit, i zotëruar në shumicë nga AFD dhe personeli i së cilës i është vënë tërësisht në dispozicion nga AFD;

- ka si mision kryesor të favorizojë investimet private në vendet emergjente dhe në vendet në zhvillim në favor të rritjes, zhvillimit të qëndrueshëm dhe realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ);

- financon operacione ekonomisht të zbatueshme, shoqërisht të drejta, të qëndrueshme në planin mjedisor dhe financiarisht rentabël;

- investon në një hapësirë gjeografike që shkon nga vendet e mëdha emergjente në vendet më të varfra, me një nivel të lartë kërkesash në fushën e përgjegjësisë sociale dhe mjedisore;

- propozon një gamë të plotë instrumentesh financiare që lejojnë të plotësohen nevojat specifike të investuesve privatë në vendet në zhvillim (hua, kapitale të vetat, instrumente të gati-kapitaleve të veta, garanci dhe inxhinieri financiare);

- ndërhyt vetëm kur asnjë institucion tjetër financiar vendor nuk është në gjendje të propozojë produkte ose shërbime financiare të ngjashme ose kur institucionet financiare vendore kanë nevojë për një ndihmë shtesë për të siguruar një financim;

Duke kujtuar se *Expertise France*, një entitet i sektorit publik i krijuar në vitin 2014;

- mobilizon ekspertizën franceze dhe ndërkombëtare për të mbështetur përcaktimin dhe zbatimin e politikave publike që u përgjigjen sfidave institucionale, ekonomike, demografike, sociale dhe mjedisore;

- ndërhyt për të përforcuar politikat publike të vendeve partnere dhe, në bashkëveprim me vendet përfituese dhe donatorët, në fazat kryesore të ciklit të projektit (identifikim, formulim, zbatim dhe ndjekje) dhe propozon një gamë të gjerë ndërhyrjesh (vënie në dispozicion të një ekspertize afatshkurtër dhe afatgjatë, organizim ateliesh, seminaresh, trajnimesh, vizitash studimore, etj) që mbështeten mbi një qasje të integruar të politikave publike;

- sjell ekspertizën dhe mbështetjen e saj për autoritetet kombëtare për përcaktimin dhe zbatimin e politikave publike në kuadrin e projekteve ndërkombëtare me financime publike franceze, evropiane, të bankave të zhvillimit, të vendeve përfituese ose me financime të fondacioneve private.

Duke kujtuar se është në interesin e përbashkët të Palëve ta nënshkruajnë këtë Marrëveshje për t'i lejuar Grupit AFD dhe *Expertise France* të sjellin asistencën e tyre financiare dhe teknike në Shqipëri, në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë;

Duke kujtuar se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dëshiron t'i japë disa privilegje dhe përjashtime Grupit AFD dhe *Expertise France* për të lehtësuar përmbushjen e misioneve të tyre në kuadrin e politikës në lidhje me financimin e zhvillimit të Shqipërisë;

Duke kujtuar se Shqipëria dhe Franca aderojnë në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961. Për pasojë, në bazë të respektimit të parimeve të pavarësisë, të barazisë sovraane dhe mosndërhyrjes në punët e brendshme, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Francës, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1. Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar të sjellin një asistencë financiare dhe teknike dhe të investojnë në Shqipëri.



1.2 Kjo Marrëveshje ka si objekt të përcaktojë rregullat e zbatueshme për themelimin dhe ushtrimin e aktiviteteve të Grupit AFD dhe *Expertise France* në Shqipëri. Ajo përcakton kushtet juridike, fiskale dhe financiare të zbatueshme për statusin dhe veprimtaritë e Grupit AFD dhe *Expertise France* në këtë vend.

Neni 2

Statusi juridik i grupit AFD dhe të *Expertise France*

2.1 Grupi AFD dhe *Expertise France* gëzojnë personalitetin dhe aftësinë juridike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive të tyre në Shqipëri dhe, me këtë cilësi, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe me legjislacionin përkatës shqiptar mund të lidhin kontrata, të blejnë dhe të shesin pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe t'u drejtohen gjykatave.

2.2 Grupi AFD dhe *Expertise France* munden:

- a) të ushtrojnë çdo veprimtari të nevojshme për përmbushjen e misioneve të tyre ashtu siç përshkruhen në këtë Marrëveshje;
- b) të negociojnë dhe lidhin çdo lloj marrëveshjeje dhe kontrate;
- c) të pranojnë çdo lloj garancie ose dorëzanie;
- d) të punësojnë personel me shtetësi shqiptare, franceze ose shtetësi të treta.

Neni 3

Veprimtaritë e grupit AFD dhe të *Expertise France* në Shqipëri

3.1 Në zbatim të dispozitave të kësaj marrëveshjeje Grupi AFD dhe *Expertise France* munden:

- a) t'u japin në Republikën e Shqipërisë ndihmë financiare në euro, në dollarë amerikanë ose në çfarëdolloj tjetër valute dhe çdo formë tjetër asistence financiare ose teknike, si për shembull garanci, enteve, ndërmarrjeve publike ose private dhe institucioneve financiare, si dhe shoqatave ose organizatave publike ose private kombëtare, të huaja ose ndërkombëtare, si dhe çdo personi juridik me seli në Shqipëri;
- b) në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar për veprimtarinë e zhvilluar në territorin e Republikës së Shqipërisë të blejnë lirisht çdo lloj pjesëmarrjeje në kapitalin e çdo shoqërie

(pavarësisht nga forma e saj) pranë çdo shitësi, të investojnë në fonde investimi dhe t'i transferojnë ose shesin pjesëmarrjen e tyre ose pjesët e saj çdo personi shqiptar ose të huaj;

c) të kryejnë shërbimet e konsulencës, asistencës teknike, trajnimit ose studimeve për entet publike ose private.

3.2 Secila prej veprimtarive të përmendura më sipër është objekt i një kontrate ose një marrëveshjeje specifike që përcakton detyrimet dhe angazhimet e palëve të interesuara nga veprimtaria ose operacioni në fjalë. Çdo Palë zotohet të bëjë gjithçka mundet për të lehtësuar kryerjen e formaliteteve eventuale të kërkuara për të siguruar vlefshmërinë ose hyrjen në fuqi të kontratës në fjalë ose marrëveshjes në fjalë.

3.3 Ushtrimi i veprimtarive të Grupit AFD dhe *Expertise France* nuk kërkon asnjë autorizim ose licencë të karakterit ligjor, nënligjor ose administrativ, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë marrëveshje.

3.4 Marrëveshjet dhe kontratat e lidhura nga AFD me Republikën e Shqipërisë ose çdo ent publik ose privat shqiptar në kuadrin e veprimtarive të tij nënshkruhen në gjuhën frënge dhe në gjuhën shqipe. Vlefshmëria dhe efektet e tyre nuk kërkojnë kryerjen e një përkthimi të autorizuar dhe/ose të noteruar në një gjuhë tjetër.

3.5 Marrëveshjet që lidhen nga AFD me Republikën e Shqipërisë ose çdo entitet publik ose privat shqiptar në kuadrin e asistencës financiare si: hua, grante dhe garanci, rregullohen nga e drejta franceze dhe i nënshtrohen kompetencës së një juridiksioni francez ose të një gjykate arbitrazhi ndërkombëtare të zgjedhur me marrëveshje të përbashkët, ose të çdo organi tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dhe vendimet ose arbitrazhet e shpallura njihen dhe ekzekutohen plotësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Përfshirja nga rregullimi bankar

4.1 Veprimtaritë dhe operacionet e Grupit AFD dhe *Expertise France* konsiderohen si të përgatitura, të vendosura dhe të zbatuara që nga selitë e tyre respektive, të vendosura në Francë.

4.2 Grupi AFD, *Expertise France* dhe Përfaqësia (Përfaqësitë) e tyre, ashtu siç përcaktohet në Nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, nuk kanë statusin e bankës



ose të çfarëdolloj institucioni tjetër financiar në Shqipëri.

Neni 5

Konvertimi dhe transferimet

5.1 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizon me anë të kësaj Marrëveshjeje:

i) çdo përfitues të një financimi të Grupit AFD ose të *Expertise France* apo çdo garantues të një financimi të tillë;

ii) çdo bankë ndërmjetëse shqiptare ose e huaj e ngarkuar me transferimin e fondeve; si dhe

iii) Grupin AFD dhe *Expertise France*,

të konvertojnë në valuta të huaja, me kursin e këmbimit të rënë dakord midis një zyre këmbimi dhe pronarit të fondeve ose të kursit të botuar nga Banka e Shqipërisë në datën e konvertimit, dhe të transferojë lirisht jashtë territorit të Shqipërisë pa kufizime, pa miratim paraprak, çdo shumë që i detyrohet Grupit AFD ose *Expertise France*, konkretisht shumat që u korrespondojnë shlyerjes së financimeve, si në principal ashtu edhe në interesa, kamatë-vonesave, shpenzimeve shtesë, si dhe çdo shumë tjetër që duhet paguar për shkak të ushtrimit ose të kryerjes së veprimtarive të Grupit AFD ose *Expertise France* në Shqipëri.

5.2 Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar gjithashtu të zotërojnë llogari bankare në Shqipëri në çdo valutë, si të konvertojnë në valuta të huaja, me kursin e këmbimit të rënë dakord midis një zyre këmbimi dhe pronarit të fondeve ose të kursit të botuar nga Banka e Shqipërisë në datën e konvertimit, dhe të transferojnë lirisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa kufizime, pa miratim paraprak, çdo shumë që rezulton nga shitja e pjesëmarrjeve ose e pronave të luajtshme ose të paluajtshme, çdo dividend dhe shpërndarje tjetër, çdo fitim, çdo mbivlerë, çdo produkt të realizimit dhe në përgjithësi çdo të ardhur, çdo komision ose çdo kapital të çfarëdolloj natyre qoftë, përfshi gjithashtu dëmshpërblimet dhe interesat që rezultojnë nga një vendim gjyqësor ose nga një vendim arbitrazhi, kur shumat të tilla vijnë në mënyrë parësore ose të lidhur me çdo investim ose çdo operacion të Grupit AFD ose *Expertise France* në Shqipëri, ose nga realizimi i tyre.

5.3 Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar, sipas rastit, të kryejnë, në ekzekutim të huave ose të çdo operacioni tjetër financiar,

këmbimi ose kreditimi, pagesa direkte për furnizuesit ose bashkë-kontraktuesit e huamarrësit ose të përfituesit të interesuar, jo të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur këto përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve që nuk vijnë nga Shqipëria, dhe janë të autorizuar, po të jetë e nevojshme, të përfitojë nga rimbursimi direkt i financimeve të tyre përmes valutave të mbajtura jashtë Shqipërisë.

5.4 Në rast se bankat shqiptare do të refuzojnë të kryejnë ose nuk do të kenë mjaftueshëm valuta të huaja për të kryer një konvertim ose një transferim, ose nëse, për çfarëdolloj arsyeje qoftë, një konvertim ose një transferim nuk kryhet nga bankat shqiptare sepse ato nuk janë të autorizuar të konvertojnë monedhën shqiptare të Grupit AFD dhe *Expertise France*, si dhe të kryejnë transferimin e tyre jashtë shtetit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (përmes Bankës së Shqipërisë) bën gjithçka është e mundur, në afatet më të mira dhe duke marrë masat e nevojshme, për ta konvertuar monedhën shqiptare në valuta të huaja, me kursin e këmbimit të zbatueshëm të botuar nga Banka e Shqipërisë në datën e konvertimit, dhe kryen transferimin e tyre në llogaritë bankare të huaja të Grupit AFD dhe *Expertise France*.

Neni 6

Statusi fiskal

6.1 Veprimtaritë e Grupit AFD dhe të *Expertise France*, sipas pikës 1, të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë operacionet, transaksionet, si dhe pasuritë e tyre të paluajtshme, përjashtohen nga tatimet indirekte si TVSH, nga tatimet direkte mbi të ardhurat, taksat lokale, si dhe nga mbajtja e tatimit në burim për interesat dhe dividendët, shpenzimet, komisionet dhe fitimet kapitale.

6.2 Përrjashtimet e përmendura në nenin 6.1 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen, konkretisht:

a) për çdo tatim ose detyrim direkt ose indirekt që rezulton nga lidhja ose nga ekzekutimi i marrëveshjeve të kontraktuara ose të nënshkruara në kuadrin e veprimtarive të Grupit AFD dhe të *Expertise France*, sipas pikës 1, të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje;

b) për pagat dhe çdo lloj shpërblimi të paguar nga Grupi AFD ose *Expertise France* punonjësve të tyre që nuk janë shtetas shqiptarë.



6.3 Asnjë ent apo ndërmarrje publike ose private, që i paguan interesa, dividendë, komisione, honorare ose çdo shumë tjetër Grupit AFD ose *Expertise France*, nuk është i detyruar të mbajë tatimin në burim për këto pagesa.

6.4 Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të përjashtuar nga çdo detyrim për deklarim tatimor në lidhje me aktivitetet e zhvilluara në përputhje me pikën 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Statusi i përfaqësimit të grupit AFD dhe *Expertise France* në Republikën e Shqipërisë

7.1 Përfaqësimi i Grupit AFD dhe *Expertise France* në Shqipëri

a) Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parashikimet e kësaj marrëveshjeje të hapin një ose disa përfaqësi në territorin e Republikës së Shqipërisë (në vijim e quajtur “Përfaqësia” ose “Përfaqësitë”), me qëllim që të ushtrojnë veprimtaritë e përshkruara në këtë Marrëveshjeje.

b) Pala shqiptare lehtëson hapjen dhe funksionimin e çdo Përfaqësie në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

c) Përfaqësitë e Grupit AFD ose të *Expertise France* në Shqipëri janë të ngarkuara të identifikojnë projektet që Grupi AFD ose të *Expertise France* mund të realizojnë në Republikën e Shqipërisë, me përgatitjen dhe negocimin e dokumenteve të lidhura me këto projekte, si dhe me ndjekjen e ekzekutimit të tyre.

d) Vetëm selitë qendrore respektive të enteve të Grupit AFD dhe të *Expertise France* në Francë janë të ngarkuara dhe përgjegjëse për: (i) procedurën e shqyrtimit të projekteve, (ii) vlerësimin e tyre, (iii) vendimet e financimit, (iv) derdhjen e fondeve dhe (v) ndjekjen e rimbursimeve.

e) Në përputhje me dispozitat e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje, veprimtaritë e Përfaqësive nuk u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme për bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

f) Grupi AFD dhe *Expertise France* nuk konsiderohen se kanë vendndodhje të përhershme në Republikën e Shqipërisë dhe si rrjedhojë të ardhurat që i korrespondojnë veprimtarive sipas pikës 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje nuk iu atribuohen Përfaqësive të tyre.

g) Grupi AFD dhe *Expertise France* në Republikën e Shqipërisë përfitojnë të gjitha privilegjet dhe imunitetet që u njihen përfaqësive diplomatike në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të 18 prillit 1961.

7.2 Personeli i huaj i Grupit AFD dhe *Expertise France*

a) Grupi AFD dhe *Expertise France* përcaktojnë numrin dhe kualifikimet e anëtarëve të personelit të tyre që nuk kanë shtetësinë shqiptare, apo shtetasve të huaj që nuk kanë rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë (në vijim të quajtur “Punonjësit e huaj”) që ata i vlerësojnë të nevojshëm për mirëfunksionimin e Përfaqësive/Përfaqësive të tyre.

b) Grupi AFD dhe *Expertise France* marrin përsipër koston e plotë të pagave, kompensimeve dhe transportit të Punonjësve të huaj. Këta punonjës përfitojnë nga regjimet e sigurimeve shoqërore dhe të pensione franceze dhe nuk u nënshtrohen, pra, dispozitave përkatëse që mund të zbatohen në Republikën e Shqipërisë.

c) Pala shqiptare u njeh Punonjësve të huaj të Përfaqësive imunitetin e juridiksionit për veprimet e kryera gjatë ushtrimit zyrtar të funksioneve të tyre.

d) Pala shqiptare u njeh punonjësve të huaj dhe anëtarëve të familjeve të tyre:

- të drejtën e pajisjes me vizë afatgjatë me disa hyrje-dalje me qëllim pajisjen me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- të drejtën për t'u përjashtuar nga tatimet mbi të ardhurat ose nga çdo tatim i ngjashëm që lidhet me pagat, shpërblimet dhe alokacionet që u paguhen për shkak të veprimtarisë së tyre për Grupin AFD dhe *Expertise France* në Shqipëri;

- lëshimin për bashkëshortin ose partnerin e Punonjësit të huaj të një leje pune të vlefshme për të njëjtën periudhë me vizën ose lejen e hyrjes të Punonjësit të huaj në fjalë, që i lejon bashkëshortit ose partnerit të punojë në Republikën e Shqipërisë;

- të drejtën të importojnë pa taksa objektet dhe sendet e tyre personale në momentin e marrjes së funksionit të parë në Shqipëri;

- lëshimin e çdo autorizimi të nevojshëm për transportimin e lirë të sendeve personale drejt Shqipërisë dhe nga Shqipëria jashtë saj.

7.3 Personeli lokal i Grupit AFD dhe i *Expertise France* në Shqipëri



a) Në kuadrin e veprimtarive të tyre në Shqipëri Grupi AFD dhe *Expertise France* mund të punësojnë punonjës me shtetësi shqiptare ose që banojnë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare në fushën e të drejtës së punës, sistemit tatimor dhe sigurimeve shoqërore.

b) Këta punonjës gëzojnë imunitet nga juridiksioni vetëm për veprimet e kryera në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare.

7.4 Misionet e përkohshme në Shqipëri

a) Për të kryer me sukses veprimtaritë e tyre në Shqipëri, Grupi AFD dhe *Expertise France* mund të dërgojnë misione të përkohshme në Shqipëri ose të mandatojnë konsulentë për të mbledhur të dhënat e nevojshme për përgatitjen dhe/ose ekzekutimin e projekteve.

b) Pala shqiptare në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar merr masat e nevojshme që anëtarët e misionëve të përkohshme të marrin në afat të shkurtër autorizimet e nevojshme për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë.

c) Për sa i përket rregullave në fushën e migracionit, anëtarët e misionëve të përkohshme përfitojnë nga rregullat e brendshme në fuqi të zbatueshme për personelin në mision të institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Pala shqiptare iu njeh anëtarëve të misionit të përkohshëm në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre zyrtare:

a) Imunitet nga juridiksioni vetëm për veprimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare;

b) Paprekshmërinë e dokumenteve të tyre zyrtare.

Imunitetet e parashikuara në pikat a dhe b të këtij paragrafi nuk i përjashtojnë anëtarët e misionit të përkohshëm nga juridiksioni i palës franceze.

Neni 8

Zbatimi i marrëveshjes

8.1. Me qëllim që të lehtësojë përpjekjet e Grupit AFD dhe të *Expertise France* për zbatimin e veprimtarive të tyre, pala shqiptare u transmeton institucioneve të saj të gjitha informacionet e nevojshme për të lejuar ekzekutimin e plotë të kësaj

Marrëveshjeje në afatet më të mira dhe merr të gjitha masat e brendshme për këtë qëllim.

8.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar t'ia paraqesin këtë Marrëveshje, qoftë si referencë, qoftë përmes një kopjeje, çdo autoriteti, çdo nëpunësi dhe në përgjithësi, çdo institucioni publik të Republikës së Shqipërisë. Për t'iu lejuar përfituesve të financimeve të Grupit AFD ose të *Expertise France*, ose bashkë-kontraktuesve të AFD ose të *Expertise France*, të kërkojnë zbatimin e të drejtave të përmendura në këtë Marrëveshje, Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar t'iu komunikojë një kopje të kësaj Marrëveshjeje këtyre përfituesve ose bashkë-kontraktuesve, me qëllim që ata të mund t'ia paraqesin autoriteteve të interesuara.

8.3 Asnjë dispozitë ligjore, nënligjore ose dispozitë tjetër që bëhet efektive pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të cenojë të drejtat dhe privilegjet e Grupit AFD ose *Expertise France* të parashikuara nga kjo Marrëveshje.

Neni 9

Hyrja në fuqi

9.1 Secila prej Palëve njofton Palën tjetër me shkrim për plotësimin e procedurave kushtetuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, që merr efekt një muaj pas datës së marrjes së njoftimit të fundit.

9.2 Menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, pala shqiptare, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kryen regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara. Qeveria e Republikës së Francës do të informohet për këtë regjistrim përmes transmetimit të numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, menjëherë pas marrjes së konfirmimit nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

9.3 Kjo Marrëveshje zbatohet për marrëveshjet dhe kontratat që lidhin Grupi AFD ose *Expertise France* në Shqipëri.

Neni 10

Ndryshimet

Palët munden, në çdo moment dhe me marrëveshje të përbashkët, të ndryshojnë me



shkrim këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim bëhet efektiv pas përmbushjes nga secila prej Palëve të procedurave të brendshme përkatëse dhe bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshje.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis Palëve që rrjedh nga interpretimi ose nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhet miqësisht nëpërmjet negocimit mes palëve në rrugë diplomatike.

Neni 12

Kohëzgjatja dhe denoncimi

12.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të papërcaktuar por afati i saj do të mbarojë në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

12.2 Ajo mund të denoncohet në çdo moment nga secila prej Palëve. Denoncimi hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit në rrugë diplomatike. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje nuk prek kontratat ose marrëveshjet në vazhdim të lidhura gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

Bërë në Bruksel, më 17 shkurt 2020, në dy (2) kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe frënge, ku të dyja tekstet kanë vlerë të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË QIPËRISË

Edi Rama

Kryeministër
dhe

Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË FRANCËS

Jean-Yves Le Drian

Ministër i
Evropës dhe i Punëve të Jashtme

DEKRET

Nr. 11468, datë 29.4.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 48/2020 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës në lidhje me themelimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, të *Proparco* dhe të *Expertise France* në Shqipëri”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 7, datë 21.4.2020

PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E REGJISTRIT PËR PRODUKTET BUJQËSORE DHE USHQIMORE ME TREGUES SPECIALITET TRADICIONAL I GARANTUAR

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 8/2019, datë 28.2.2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e regjistrit për produktet bujqësore dhe ushqimore me emërtim “Specialitet Tradicional i Garantuar” (STG), sipas aneksit bashkëlidhur.

2. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në ligjin nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”.

3. Struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në Ministri, kryen hedhjen e të dhënave në regjistrin elektronik, për produktet bujqësore dhe ushqimore



me emërtimin STG, duke përcaktuar statusin e veprimit:

- a) Aplikuar;
- b) Publikuar;
- c) Regjistruar.

Pas marrjes së kërkesës së aplikimit, për regjistrim të emërimit STG, të produktit bujqësor apo ushqimor, struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në Ministri hedh të dhënat në regjistër me statusin “Aplikuar”.

4. Pas verifikimit formal, struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në Ministri, hedh të dhënat në regjistër me statusin “Publikuar”.

Verifikimi formal është procedura paraprake për verifikimin e plotësisë të dokumentacionit të mëposhtëm të kërkesës së aplikimit për regjistrim:

a) emrin dhe adresën e grupit të prodhuesve ose të personit që vepron në emër të grupit;

b) specifikimet e produktit, të cilat përfshijnë:

i. emrin që do të regjistrohet si emërtim STG, ashtu siç përdoret në treg ose në gjuhën e zakonshme;

ii. një përshkrim të produktit, përfshirë karakteristikat e tij kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike apo organoleptike, që tregojnë karakterin e veçantë të produktit;

iii. një përshkrim të metodës së prodhimit, që prodhuesit duhet të ndjekin, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, natyrën dhe karakteristikat e lëndëve të para ose përbërësve të përdorur apo mënyrën e veçantë të prodhimit të tyre;

iv. vetitë kryesore, që krijojnë karakterin tradicional të produktit.

c) kategorinë e produktit bujqësor ose ushqimor;

d) informacionin mbi procedurën dhe shpeshësinë e kontrollit për përputhshmërinë e produktit me specifikimet;

e. një përmbledhje të specifikimeve të produktit, në veçanti të dhënat e përcaktuara në nënndarjet “i”- “iv”, të shkronjës “b”, të kësaj pike;

f) listën e dokumenteve të paraqitura, së bashku me aplikimin për regjistrim;

g) dokumentin që konfirmon pagesën e tarifës për regjistrim.

5. Struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në Ministri, pas marrjes së një vlerësimi pozitiv nga komisioni dhe nëse nuk ka pasur kundërshtime nga subjekte të treta në lidhje me emërtimin STG të

publikuar, pasqyron të dhënat në regjistër me statusin “Regjistruar”.

6. Në rast refuzimi të kërkesës për regjistrim, të dhënat hiqen nga regjistri, për produktet bujqësore dhe ushqimore me emërtim STG.

7. Regjistri për produktet bujqësore dhe ushqimore me emërtim STG është publik dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë.

8. Për produktet bujqësore apo ushqimore me emërtimin STG, regjistri përmban të dhënat, si më poshtë:

a) numrin e kërkesës së aplikimit për regjistrim të produktit bujqësor apo ushqimor, i cili është numri i protokollit hyrës në Ministri;

b) datën e depozitimit të kërkesës, në protokollin e Ministrisë;

c) numrin dhe datën e regjistrimit në regjistër të kërkesës së aplikimit, që do të jetë: STG-qarku, sipas aneksit nr. 2, - numri i protokollit hyrës në Ministri;

d) emrin e STG, sipas përcaktimit në formularin e aplikimit;

e) produktin e klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor me emërtimin STG;

f) një përshkrim të produktit, përfshirë karakteristikat e tij kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike apo organoleptike, që tregojnë karakterin e veçantë të produktit; sipas formularit të aplikimit;

g) vetitë kryesore, që krijojnë karakterin tradicional të produktit;

h) emrin dhe adresën e autoritetit ose organit përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet e produktit;

i) emrin dhe adresën e mbajtësit/mbajtësve të së drejtës së përdorimit të emërimit STG, të produktit bujqësor apo ushqimor.

9. Nëse operatori nuk plotëson brenda afatit të caktuar parregullsitë, AKU-ja ose trupa certifikuese shfuqizon certifikatën. Struktura përgjegjëse në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit kryejnë veprime për:

a) ndalimin e përdorimit të emërtimeve STG, EOM, ose TGJM, përdorimin e simboleve të tyre apo shprehjeve, shkurtesave në shqip apo anglisht STG, PDO, ose PGI;

b) ndalimin e vendosjes së produktit bujqësor ose ushqimor në treg;



c) tërheqjen e produktit bujqësor ose ushqimor, nëse është vendosur në treg.

Emri i produktit bujqësor ose ushqimor me emërtim STG, hiqet nga regjistri.

10. Informimi i publikut për dokumente dhe informacione të tjera, lidhur me procedurën e regjistrimit të një produkti bujqësor apo ushqimor me emërtimin STG, që disponohet nga struktura përgjegjëse, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.

11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Struktura Përgjegjëse për Skemat e Cilësisë së Produkteve Bujqësore dhe Ushqimore në Ministri dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

ANEKSI 1

FORMA E REGJISTRIT

Nr. kërkesës	Nr. i regjistrimit	Data e regjistrimit	Data e depozitimit	Emri STG	Klasifikimi i produktit	Përshkrimi i produktit	Vetitë	Emri & adresa e organit përgjegjës	Emri & adresa e përdoruesit

ANEKSI 2

LISTA E SHKURTIMEVE

Nr.	Emërtimi i qarkut	Shkurtimi
1	Berat	BR
2	Dibër	DI
3	Durrës	DR
4	Elbasan	EL
5	Fier	FR
6	Gjirokastrë	GJR
7	Korçë	KO
8	Kukës	KU
9	Lezhë	LE
10	Shkodër	SHK
11	Tiranë	TR
12	Vlorë	VL

**URDHËR¹****Nr. 141, datë 16.4.2020****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
MBI PARASHTRIMIN E KËRKESAVE TË
PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE
DHE PROCEDURAT OPERACIONALE
NË LIDHJE ME LUNDRIMIN AJROR
NË BAZË TË PERFORMANCËS**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës ç, të nenit 7, të pikës 1/d, të nenit 9, të ligjit 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi parashtrimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operacionale në lidhje me lundrimin ajror në bazë të performancës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

¹ Ky urdhër përafuron Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2018/1048, e datës 18 korrik 2018, mbi parashtrimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operacionale në lidhje me lundrimin ajror në bazë të performancës, botuar në Fletoren Zyrtare të BE, L 189, datë 26.7.2018.

RREGULLORE

**MBI PARASHTRIMIN E KËRKESAVE TË
PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE
DHE PROCEDURAT OPERACIONALE NË
LIDHJE ME LUNDRIMIN AJROR NË BAZË
TË PERFORMANCËS**

Neni 1**Objekti dhe fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për përdorimin e hapësirës ajrore dhe procedurat e operimit në lidhje me lundrimin mbi bazën e performancës.

2. Kjo Rregullore aplikohet për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimet e lundrimit ajror (MTA/SHLA) dhe operatorëve të aerodromeve (në tekstin më poshtë ‘ofruesit e MTA/SHLA’) që janë përgjegjës për hartimin e procedurave të afërimit instrumental apo shërbimit të trafikut ajror (ATS) në rrugët ajrore, ku ata ofrojnë shërbimet e tyre në hapësirën ajrore si më poshtë:

a) mbi hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë,

b) çdo hapësirë tjetër ajrore ku Shteti Shqiptar është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në përputhje me nenin 1(2) të udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 7 datë 3.6.2010, “Mbi Organizimin dhe Përdorimin e Hapësirës Ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian”, që përafuron Rregulloren (KE) nr. 551/2004.

Neni 2**Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. ‘lundrim i bazuar në performance (PBN)’ nënkupton lundrimin e bazuar në performancë, siç përcaktohet në nenin 2(8) të Rregullores së miratuar me urdhrin e ministrit përgjegjës për transportin nr. 151, datë 9.4.2014 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore, të ndryshuar me UM-në nr. 3746 datë 10.7.2017, që përafuron rregulloren e BE-së nr. 965/2012;

2. ‘ruga e shërbimit të trafikut ajror (ATS)’ nënkupton rrugë ajrore ku ofrohen shërbimet e trafikut ajror siç përcaktohet në nenin 2 (44) të



Rregullores së miratuar me urdhrin e ministrit përgjegjës për transportin nr. 327, datë 29.8.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror (SERA)”, që përafuron Rregulloren EU nr. 923/2012;

3. ‘procedura instrumentale e afrimit’ nënkupton procedurën e afrimit nëpërmjet instrumenteve siç përcaktohet në nenin 2 (90), të Rregullores (SERA), të miratuar me UM-në nr. 327, datë 29.8.2019;

4. ‘procedurat konvencionale të lundrimit’ nënkupton rrugët e SHTA dhe procedurat instrumentale të afrimit të bazuara në përdorimin e pajisjeve lundruese të stacionuara në tokë, që nuk mundësojnë përshtatje me kërkesat e Lundrimit të bazuar në Performancë (PBN) të përcaktuara në këtë Rregullore;

5. ‘pistë instrumentale’ nënkupton pistën instrumentale siç përcaktohet në aneksin I të Rregullores së miratuar me UM-në nr. 122, datë 12.3.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, që përafuron Rregulloren EU 139/2014;

6. ‘specifikim i lundrimit’ nënkupton një bashkësi kërkesash për avionët dhe personelin e avionit në to, që nevojiten për të mbështetur operacionet e lundrimit mbi bazën e performancës brenda një hapësire ajrore të përcaktuar;

7. ‘specifikimi ‘X’ i performancës lundruese të kërkuar (RNP)’ nënkupton një specifikim lundrimi i bazuar mbi lundrimin ajror, që përfshin kërkesat e monitorimit të performancës dhe alarmit në bordin e mjetit ajror, ku ‘X’ i referohet saktësisë lundruese anësore, e shprehur në milje detare, ose llojin e operimit, se bashku me funksionalitetet e kërkuara;

8. ‘lundrimi anësor (LNAV)’, ‘lundrimi anësor/lundrimi vertikal (LNV /VNAV)’ dhe ‘performanca e lokalizuesit me udhëzim vertikal (LPV)’ nënkuptojnë simbole për të identifikuar llojet e ndryshme të minimeve të operimit (lartësi minimale) në hartat e afrimit, të cilat përshkruajnë procedurat e afrimit bazuar në Sistemet Satelitore të Lundrimit Global (GNSS) të cilat klasifikohen si afrime RNP (RNP APCH);

9. ‘trajektorja rrethore drejt pikës fikse (RF)’ nënkupton një segment harkor që përfundon në një pikë fikse;

10. ‘Afrim 2D’ nënkupton një procedurë instrumentale të afrimit, e klasifikuar si një procedurë e afrimit ‘jo e saktë’, siç përcaktohet në rregulloren e miratuar me UM-në nr. 327, datë 29.8.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror (SERA)”, që përafuron Rregulloren BE nr. 923/2012;

11. ‘Afrim 3D’ do të thotë një procedurë instrumentale e afrimit, e klasifikuar si një afrim me udhëzim vertikal ose si një afrim ‘i saktë’, siç përcaktohet në rregulloren e miratuar me UM-në nr. 327, datë 29.8.2019, që përafuron Rregulloren EU nr. 923/2012

12. ‘sistemi i përforcimit të sinjalit satelitor (SBAS)’ nënkupton një sistem satelitor me mbulim të gjerë, ku përdoruesi i GNSS (*Global Navigation Satellite System*) merr informacion të përforcuar nga një transmetues satelitor;

13. ‘specifikim X i një zone lundrimi (RNAV)’ nënkupton një specifikim lundrimi të bazuar mbi hapësirën e lundrimit ajror, që nuk përfshihen kërkesat e monitorimit të performancës dhe alarmit në bordin e mjetit fluturues, ku ‘X’ i referohet saktësisë lundruese anësore në milje detare;

14. ‘rrugë standarde afrimi instrumental (STAR)’ nënkupton një rrugë ajrore afrimi me rregulla instrumentale të fluturimit e cila lidh një pikë sinjifikative, normalisht brenda një rruge ku mbulohet me shërbim të trafikut ajror, me një pikë tjetër në të cilën mund të fillojë një procedurë instrumentale e publikuar afrimi;

15. ‘rrugë standarde instrumentale nisjeje (SID)’ nënkupton një rrugë të caktuar të nisjes me anë të rregullave instrumentale të fluturimit që lidh aerodromin me një pikë të caktuar, zakonisht në një rrugë të caktuar SHTA, në të cilën fillon faza ‘en-route’ e fluturimit;

16. ‘funksionaliteti i lundrimit’ nënkupton aftësinë e detajuar të sistemit lundrues, të nevojshëm për të përmbushur kërkesat e operimeve të propozuara në një hapësirë të caktuar ajrore.



Neni 3

Kërkesat e PBN-së

Ofruesit e MTA/SHLA do të operojnë në përputhje me kërkesat për implementimin e lundrimit të bazuar mbi performancë të përcaktuar në nën paragrafin LBP (PBN) të shtojcës.

Neni 4

Masat tranzitore

1. Ofruesit e MTA/SHLA do të marrin masat e nevojshme për të siguruar një kalim të butë dhe të sigurt në ofrimin e shërbimeve të tyre duke përdorur lundrimin e bazuar mbi performancë, në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Këto masa do të përfshijnë krijimin dhe zbatimin e një plani tranzicioni. Ofruesit e MTA/SHLA duhet të mbajnë planin e tyre të tranzicionit të përditësuar.

Plani i tranzicionit do të jetë në përputhje me Master Planin Evropian të MTA-ve dhe projektet e përbashkëta të përmendura në udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportet nr. 6, datë 3.6.2010 “Mbi Dispozitat e Shërbimit të Navigimit Ajror në Qiellin e Vetëm Evropian”.

2. Ofruesit e MTA/SHLA do të konsultohen me të gjithë palët e përmendur më poshtë mbi draftin e planit të tranzicionit dhe draftin e çdo përditësimi thelbësor të tij, si edhe të marrin parasysh pikëpamjet e tyre kur është e përshtatshme:

a) operatorët e aerodromit, përdoruesit e hapësirës ajrore dhe përfaqësuesit e organizatave që përdorin hapësirën ajrore të prekur nga ofrimi i shërbimeve të tyre;

b) ofruesve të MTA/SHLA që ofrojnë shërbimet e tyre në blloqet e afërta të hapësirës ajrore.

3. Pas kryerjes së konsultimeve të referuara në paragrafin 2, ofruesit e MTA/SHLA do të dorëzojnë rezultatet e konsultimit, si dhe draftin e planit të tranzicionit ose draftin me përditësimet thelbësore të tij, për aprovim tek Autoriteti i Aviacionit Civil.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë nëse draft-plani i tranzicionit, ose drafti me përditësimet thelbësore të tij, është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe në veçanti, nëse ai merr parasysh pikëpamjet e përdoruesve të hapësirës ajrore, kur është e përshtatshme, duke përfshirë

dhe operatorët e “Avionët Shtetëror”. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të parashikojë që një verifikim i tillë të kryhet në koordinim me autoritetet e tjera përkatëse të vendeve që zbatojnë këtë rregullore.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të informojë ofruesit e MTA/SHLA për rezultatin e verifikimit pa vonesa të panevojshme. Ofruesit e MTA/SHLA nuk do të ngrenë apo zbatojnë planin e tranzicionit, ose përditësimin e rëndësishëm të tij, para se të njoftohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil pasi është ky i fundit që miraton draft planin e tranzicionit apo draftin me përditësimet thelbësore të tij.

Neni 5

Përdorimi ekskluziv i PBN-ve

1. Ofruesit e MTA/SHLA nuk do të ofrojnë shërbimet e tyre duke përdorur procedurat konvencionale të lundrimit, ose duke përdorur lundrimin e bazuar në performancë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e pikës AUR.PBN.2005 të shtojcës.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të konsiderohet në kundërshtim as me nenin pasardhës (neni 6), por as me mundësinë që ofruesit të MTA/SHLA të ofrojnë shërbimet e tyre duke përdorur sisteme uljeje, të afta për të kryer operime të barasvlershme me CAT II, CAT IIIA ose CAT IIIB sipas kuptimit të pikave 14, 15 dhe 16, të aneksi i 1, të Rregullores së miratuar me UM-në nr. 151, datë 09.4.2014 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore, të ndryshuar me UM-në nr. 3746 datë 10.7.2017.

Neni 6

Masat e paparashikuara

Ofruesit e MTA/SHLA do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që ato mbeten të afta të ofrojnë shërbimet e tyre me mjete të tjera ku, për arsye të papritura përtej kontrollit të tyre, GNSS-ja apo sisteme të tjera, të përdorura për lundrimin bazuar mbi performancë ,nuk janë më në dispozicion, për të ofruar shërbimet në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje. Në veçanti, këto masa do të përfshijnë ruajtjen e një rrjeti pajisjesh konvencionale lundrimi, si edhe ruajtjen e infrastrukturës së ndërlidhur të mbikëqyrjes dhe komunikimit.



Neni 7

Hyrja në fuqi dhe aplikimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e 20 (njëzetë) pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Kjo rregullore do të zbatohet nga data 3 dhjetor 2020.

Megjithatë, si përjashtim nga nënparagrafi i parë:

a) neni 5 të zbatohet nga 6 qershori 2030;

b) pika AUR.PBN.2005 (1), e shtojcës duhet të aplikohet nga 25 janari 2024;

c) për të gjitha skajet e pistës instrumentale, pika AUR.PBN.2005 (4), e shtojcës do të zbatohet nga 25 janari 2024, në lidhje me një itinerar SID ose STAR dhe që nga 6 qershori 2030, në lidhje me të gjitha rrugët SID ose STAR të vendosura;

d) për rrugët e SHTA nën nivelin e fluturimit FL 150, pika AUR.PBN.2005 (6), e shtojcës do të zbatohet nga 25 janari 2024.

SHTOJCË**Nën paragrafi LBP (PBN) - Lundrimi i bazuar mbi performancë****AUR.PBN.1005 Lënda**

Në përputhje me nenin 3 të kësaj Rregulloreje, ky nën paragraf parashtron kërkesat për zbatimin e lundrimit të bazuar në performancë (PBN) që duhet të përmbushë nga ofruesit e MTA/SHLA.

AUR.PBN.2005 Rrugët dhe procedurat

1. Ofruesit e MTA/SHLA do të hartojnë, për të gjitha skajet e pistave instrumentale, procedura afrimi në përputhje me kërkesat e specifikimit të afrimit RNP (RNP APCH), duke përfshirë LNAV, LNAV/VNAV, standardi i minimeve LPV-se, si edhe funksionaliteti i trajektores rrethore drejt pikës fikse (RF), dhe kur kërkohet nëse dendësia dhe kompleksiteti i trafikut, e bëjnë të domosdoshme këtë të fundit.

2. Si përjashtim nga pika 1, në skajet e pistave instrumentale, ku për shkak të terrenit, pengesave apo standardeve të ndarjes së trafikut ajror, hartimi i procedurave 3D të afrimit rezulton veçanërisht i vështirë, ofruesit e MTA/SHLA do të hartojnë procedura afrimi 2D në përputhje me kërkesat e specifikimit RNP të afrimit (RNP APCH). Në këtë rast, ofruesit e MTA/SHLA mundën gjithashtu që përveç procedurave të afrimit 2D, të hartojnë dhe procedura afrimi 3D në pajtim me

përcaktimet e specifikimit të afrimit me “autorizim të kërkuar” (RNP AR APCH).

3. Si përjashtim nga pika 1, në skajet e pistave instrumentale, ku nuk ka mbulim të përshtatshëm me sinjal SBAS, ofruesit e MTA/SHLA do të hartojnë procedurat e specifikimit RNP APCH, duke përfshirë minimumet LNAV dhe LNAV/VNAV. Ofruesit e MTA/SHLA gjithashtu do të hartojnë procedura të bazuara mbi minimumet LPV, jo më vonë se 18 muaj nga data në të cilën është e disponueshme mbulimi i tillë i përshtatshëm me sinjal SBAS.

4. Krijimi i rrugëve SID apo STAR nga ofruesit e MTA/SHLA, do të bëhet në përputhje me kërkesat e specifikimeve të RNAV 1.

5. Përjashtimisht nga pika 4, kur ofruesit e MTA/SHLA kanë vendosur rrugë SID ose rrugë STAR dhe ku kërkohen kërkesa më të larta të performancës nga ato të përmendura në atë pikë për të ruajtur kapacitetin e trafikut ajror dhe sigurinë në mjedise me nivel të lartë dendësie të trafikut, kompleksitetit të trafikut apo tipareve të terrenit, duhet ti zbatojnë ato rrugë në përputhje me kërkesat e specifikimit të RNP 1, duke përfshirë një ose më shumë funksione shtesë të lundrimit si në vijim:

a) operacionet përgjatë një rruge vertikale dhe midis dy pikave fikse dhe me përdorimin e:

i. një “AT” në lartësinë e kufizuar;

ii. një “AT OR ABOVE” në lartësinë e kufizuar;

iii. Një “AT OR BELOW” në lartësinë e kufizuar;

iv. Një “WINDOW” lartësinë e kufizuar;

b) Trajektorja rrethore drejt pikës fikse (RF)

6. Kur ofruesit e MTA/SHLA kanë krijuar rrugët ajrore me shërbimet e trafikut ajror gjatë operimit, ata duhet ti zbatojnë ato rrugë në përputhje me kërkesat e specifikimit të RNAV 5.

7. Si përjashtim nga pikat 4 dhe 6, në rastet kur ofruesit e MTA/SHLA krijojnë rrugët, SID apo STAR, për operimet e mjeteve me rotor, ato do të hartohen në përputhje me kërkesat sipas specifikimeve të RNP 0.3, RNAV 1 ose RNP 1. Në këtë rast, ofruesve të MTA/SHLA u lind e drejta për të vendosur për përputhshmërinë me njërin nga tri specifikimet e mësipërme.



URDHËR

Nr. 255, datë 10.4.2020

**PËR DISA NRYSHIME NË URDHRIN
NR. 193, DATË 20.3.2020, “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4 dhe 15, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Kufizimin e lëvizjes, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotorë, motomjete dhe mjete) duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 11.4.2020 deri në orën 05:00, të datës 13.4.2020. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike, si dhe shërbimet në banesë (*delivery*).”.

2. Fjalja e parë e pikës 3 riformulohet si vijon:

“Ndalohej ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1, dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 11.4.2020, deri në orën 05:00, datë 13.4.2020.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

URDHËR

Nr. 256, datë 10.4.2020

**PËR DISA SHITESA DHE NRYSHIME NË
URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020, “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, I NDYRSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

“1. Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00–17:30, duke filluar nga dita e hënë, datë 13.4.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Hyrja në aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri lejohet vetëm për një person, të autorizuar, për çdo familje, për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do të jetë vetëm një herë në ditë dhe do të ketë një afat prej 90 minutash, gjatë fashës orare 05:00 deri në 17:30.

Hyrja në të gjitha dyqanet/njësitë tregtare që lejohet të hapen duhet të bëhet me radhë, duke ruajtur distancën e sigurisë prej 1.5 m nga njëri-tjetri. Çdo dyqan/njësi tregtare duhet të sigurojë maska dhe doreza për punonjësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe solucion dezinfektues për të gjithë personat që hyjnë në ambientet e dyqanit/njësisë tregtare.”.

3. Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Kufizimin e lëvizjes, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotorë,



motomjete dhe mjete) si dhe ndalimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga aktivitetet e lejuara, çdo fundjavë, duke filluar nga e premtja ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike, si dhe shërbimet në banesë (*delivery*).”

4. Fjalja e parë, e pikës 3, riformulohet si vijon:

“Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1, dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga e premtja, datë 17.4.2020 e në vijim, nga ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00, deri në një urdhër të dytë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 257, datë 10.4.2020

PËR DETAJIMIN E AKTIVITETEVE SIPAS NOMENKLATURËS SË AKTIVITETEVE EKONOMIKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, të ligjit nr. 15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, në vijim të urdhrit nr. 193, datë 20.3.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Aktivitete e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur urdhrit të nr. 193, datë 20.3.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, detajohen sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike dhe miratohen sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Aktivitete e lejuara sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri dhe urdhrit nr. 193, datë 20.3.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” e ushtrojnë aktivitetin bazuar në udhëzimet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



LISTA E AKTIVITETEVE SIPAS NOMENKLATURËS SË AKTIVITETEVE EKONOMIKE, REV.2

Statusi	Klasa	Klasa_Përshkrimi
Lejohen	111	Kultivimi i drithërave (përveç orizit), të bimëve bishtajore dhe farërave vajore
Lejohen	112	Kultivimi i orizit
Lejohen	113	Kultivimi i perimeve dhe pjepër e shalqi, rrënjore dhe tuberozë
Lejohen	114	Kultivimi i kallamsheqerit
Lejohen	115	Kultivimi i duhanit
Lejohen	116	Kultivimi i bimëve fi broze
Lejohen	119	Kultivimi i bimëve të tjera jo-shumëvjeçare
Lejohen	121	Kultivimi i hardhive
Lejohen	122	Kultivimi i frutave tropikale dhe subtropikale
Lejohen	123	Kultivimi i agrumeve
Lejohen	124	Kultivimi i frutave me bërthamë dhe frutave me farë
Lejohen	125	Rritja e të tjera pemëve e shkurreve frutore dhe e frutave të thata
Lejohen	126	Rritja e frutave vajore
Lejohen	127	Kultivimi i kulturave për pije
Lejohen	128	Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore
Lejohen	129	Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare
Lejohen	130	Shumimi i bimëve
Lejohen	141	Rritja e gjedhëve për qumësht
Lejohen	142	Rritja e të tjera gjedhëve dhe buall
Lejohen	143	Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve
Lejohen	145	Rritja e dhenve dhe dhive
Lejohen	146	Rritja e derrave
Lejohen	147	Rritja e shpendëve
Lejohen	149	Rritja e kafshëve të tjera
Lejohen	150	Ferma mikse
Lejohen	161	Aktivitetet ndihmëse për prodhimin bimor
Lejohen	162	Aktivitetet ndihmëse për prodhimet blegtorale
Lejohen	163	Punime të paskorrjes së bimëve
Lejohen	164	Përpunimi i farërave për shumim
Lejohen	170	Gjetoia, zënia me gracka dhe shërbime të lidhura me këto
Lejohen	210	Silvikultura dhe aktivitete të tjera pyjore
Lejohen	220	Shfrytëzimi i pyjeve
Lejohen	230	Mbledhja e produkteve pyjore të egra jodrusore rritur në natyrë
Lejohen	240	Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve
Lejohen	311	Peshkimi detar
Lejohen	312	Peshkimi në ujëra të ëmbla
Lejohen	321	Akuakultura detare
Lejohen	322	Akuakultura në ujëra të ëmbla
Lejohen	510	Nxjerrja e qymyrit
Lejohen	520	Nxjerrja e linjiteve
Lejohen	610	Nxjerrja e naftës bruto
Lejohen	620	Nxjerrja e gazit natyror
Lejohen	710	Nxjerrja e mineraleve hekurore
Lejohen	721	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe toriumit
Lejohen	729	Nxjerrja e mineraleve të tjera jo-metallore
Lejohen	811	Nxjerrja nga karriera e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumës dhe rrasave
Lejohen	812	Operacionet e nxjerrjes së zhavorrit dhe rrës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinës;
Lejohen	891	Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehrave kimike
Lejohen	892	Nxjerrja e torfave
Lejohen	893	Nxjerrja e kripës
Lejohen	899	Industri të tjera nxjerrëse p.k.t.
Lejohen	910	Aktivitetet mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror
Lejohen	990	Aktivitetet mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka dhe karrierat
Lejohen	1011	Prodhimi dhe përpunimi i mishit
Lejohen	1012	Prodhimi dhe përpunimi i mishit të shpendëve
Lejohen	1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe mishit të shpendëve
Lejohen	1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve
Lejohen	1031	Përpunimi dhe konservimi i patates
Lejohen	1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve
Lejohen	1039	Procese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe perimeve
Lejohen	1041	Përpunimi i vajrave dhe yndyrave



Lejohen	1042	Prodhimi i margarinës dhe yndyrave të tjera të ngjashme
Lejohen	1051	Përpunimi i produkteve të qumështit
Lejohen	1052	Prodhimi i akullores
Lejohen	1061	Përpunimi i produkteve të drithërave
Lejohen	1062	Prodhimi i niseshtesë dhe produkteve të niseshtesë
Lejohen	1071	Prodhimi i bukës; prodhimi pastave të freskëta dhe kekëve
Lejohen	1072	Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar
Lejohen	1073	Prodhimi i makaronave
Lejohen	1081	Prodhimi i sheqerit
Lejohen	1082	Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave
Lejohen	1083	Përpunimi i çajit dhe kafes
Lejohen	1084	Prodhimi i erëzave dhe salcave
Lejohen	1085	Prodhimi i ushqimeve të përgatitura
Lejohen	1086	Përgatitja e ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietetike
Lejohen	1089	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t.
Lejohen	1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës
Lejohen	1092	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake
Lejohen	1101	Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve
Lejohen	1102	Prodhimi i verës nga rrushi
Lejohen	1103	Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash
Lejohen	1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të pa distiluara
Lejohen	1105	Prodhimi i birrës
Lejohen	1106	Prodhimi i maltës
Lejohen	1107	Prodhimi i pijeve të tavolinës; prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjerë në shishe
Lejohen	1200	Prodhimi i produkteve të duhanit
Lejohen	1310	Përgatitja e fibrave tekstile dhe filatura
Lejohen	1320	Endja e tekstileve
Lejohen	1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstileve
Lejohen	1391	Prodhimi i tekstileve të tjera, pëlhurave të endura dhe thurura
Lejohen	1392	Prodhimi i artikujve tekstile të konfeksionuar, përveç veshjeve
Lejohen	1393	Prodhimi i tapeteve dhe qilimave
Lejohen	1394	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rretave
Lejohen	1395	Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve
Lejohen	1396	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale
Lejohen	1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t.
Lejohen	1411	Konfeksionimi i veshjeve prej lëkure
Lejohen	1412	Konfeksionimi i veshjeve të punës
Lejohen	1413	Konfeksionimi i veshjeve të tjera të jashtme
Lejohen	1414	Konfeksionimi i veshjeve të brendshme
Lejohen	1419	Konfeksionimi i veshjeve të tjera dhe aksesore
Lejohen	1420	Konfeksionimi i artikujve prej gëzofi
Lejohen	1431	Konfeksionimi i trikotazheve me thyesa
Lejohen	1439	Konfeksionimi i veshjeve të tjera me thyesa
Lejohen	1511	Tanini dhe regjja e lëkurës dhe ngjyrosja e gëzofit
Lejohen	1512	Prodhimi i valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme, pajimeve të kuajve dhe të tjerë
Lejohen	1520	Prodhimi i këpucëve
Lejohen	1610	Sharrimi dhe zdrukthimi i drurit
Lejohen	1621	Prodhimi i kompensatës, rimesos dhe paneleve të veçanta
Lejohen	1622	Prodhimi i parketeve për dyshe me montuar
Lejohen	1623	Prodhimi i karpentierëve të ndërtuesve dhe zdrukthëtarëve
Lejohen	1624	Prodhimi i kontejnerëve prej druri
Lejohen	1629	Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimi i artikujve prej xunkthi, shporte dhe
Lejohen	1711	Prodhimi i brumit të letrës
Lejohen	1712	Prodhimi i letrës dhe kartonit
Lejohen	1721	Prodhimi i letrës dhe kartonit të zhubrosur dhe ambalazhit të letrës dhe kartonit
Lejohen	1722	Prodhimi i artikujve prej letre me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit
Lejohen	1723	Prodhimi i letrës së zakonshme të palëvizshme
Lejohen	1724	Prodhimi i letrës së murit
Lejohen	1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartoni të p.k.t.
Lejohen	1811	Shtypshkrimi i gazetave
Lejohen	1812	Të tjera shtypshkrime
Lejohen	1813	Shërbime të para-shtypshkrimit dhe para-komunikimit
Lejohen	1814	Lidhja dhe shërbime të lidhura me të
Lejohen	1820	Riprodhimi i regjistrimeve të mjeteve të komunikimit



Lejohen	1910	Përpunimi i produkteve të furrës së koksit
Lejohen	1920	Përpunimi i produkteve të rafinerisë së naftës
Lejohen	2011	Prodhimi i gazit industrial
Lejohen	2012	Prodhimi i ngjyresve dhe pigmenteve
Lejohen	2013	Prodhimi i kimikateve të tjerë me bazë inorganike
Lejohen	2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike
Lejohen	2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit
Lejohen	2016	Përpunimi i materialeve plastike në formë primare
Lejohen	2017	Përpunimi i kauçikut sintetik në formë primare
Lejohen	2020	Përpunimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike
Lejohen	2030	Përpunimi i bojërave, vernikëve dhe shtresave të ngjashme, bojë shkrimi dhe mastiq
Lejohen	2041	Përpunimi i sapunëve dhe detergjenteve, solucioneve të pastrimit dhe shkëlqimit
Lejohen	2042	Përpunimi i parfumeve dhe solucioneve të tualetit
Lejohen	2051	Përpunimi i eksplozivëve
Lejohen	2052	Përpunimi i ngjitësve
Lejohen	2053	Përpunimi i vajrave esenciale
Lejohen	2059	Përpunimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.
Lejohen	2060	Përpunimi i fibrave sintetike dhe artificiale
Lejohen	2110	Përpunimi i produkteve farmaceutike bazë
Lejohen	2120	Përpunimi i preparateve farmaceutike
Lejohen	2211	Prodhimi i gomave dhe kamerdareve, riveshja dhe rikonstruktimi i gomave dhe kamerdareve
Lejohen	2219	Prodhimi i produkteve të tjerë prej kauçuku
Lejohen	2221	Prodhimi pllakave, fletëve, tubave dhe profileve prej plastike
Lejohen	2222	Prodhimi i mallrave të paketimit prej plastike
Lejohen	2223	Prodhimi i mallrave plastike për ndërtim
Lejohen	2229	Prodhimi i produkteve të tjera plastike
Lejohen	2311	Fabrikimi i qelqit të sheshtë
Lejohen	2312	Dhënia e formës dhe transformimi i qelqit të sheshtë
Lejohen	2313	Prodhimi i qelqit të lugët
Lejohen	2314	Prodhimi i fibrave të qelqit
Lejohen	2319	Prodhimi dhe transformimi i qelqeve të tjera, duke përfshirë qelqin teknik
Lejohen	2320	Prodhimi i produkteve refraktare
Lejohen	2331	Prodhimi i tullave dhe tjegullave prej qeramike
Lejohen	2332	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produktet e ndërtimit, në argjilë të pjekur
Lejohen	2341	Prodhimi i artikujve prej qeramike për përdorim shtëpiak dhe zbukurues
Lejohen	2342	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramike
Lejohen	2343	Prodhimi i izolatorëve qeramike dhe pajisjeve izoluese
Lejohen	2344	Prodhimi i produkteve të tjera qeramike teknike
Lejohen	2349	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike
Lejohen	2351	Prodhimi i çimentos
Lejohen	2352	Prodhimi i allçisë dhe gëlqeres
Lejohen	2361	Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi
Lejohen	2362	Prodhimi i produkteve prej allçie për qëllime ndërtimi
Lejohen	2363	Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim
Lejohen	2364	Prodhimi i llaçit
Lejohen	2365	Prodhimi i produkteve me fibrave të çimentuara
Lejohen	2369	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betoni, allçie dhe çimento
Lejohen	2370	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni
Lejohen	2391	Prodhimi i produkteve abrazive
Lejohen	2399	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike të p.k.t.
Lejohen	2410	Siderurgjia, prodhimi i hekurit dhe çelikut dhe ferroalizheve
Lejohen	2420	Prodhimi i tubave, tubacioneve dhe profilet e lugëta dhe pjesë të tjera prej çeliku
Lejohen	2431	Tërheqja në të ftohtë e shufrave
Lejohen	2432	Petëzimi në të ftohtë i rripave
Lejohen	2433	Profilizimi në të ftohtë me anë të përkuljes
Lejohen	2434	Trafilimi në të ftohtë i telave
Lejohen	2441	Prodhimi i metaleve të çmuara
Lejohen	2442	Prodhimi i aluminit
Lejohen	2443	Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit
Lejohen	2444	Prodhimi i bakrit
Lejohen	2445	Prodhimi i metaleve të tjera joferrike
Lejohen	2446	Përpunimi i metaleve nukleare
Lejohen	2451	Derdhja (fonderia) e gizës
Lejohen	2452	Derdhja (fonderia) e çelikut



Lejohen	2453	Derdhja (fonderia) e metaleve të lehtë
Lejohen	2454	Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera joferrike
Lejohen	2511	Prodhimi i strukturave metalike dhe pjesët e strukturave
Lejohen	2512	Prodhimi i dyerve dhe dritareve metalike
Lejohen	2521	Prodhimi i radiatorëve dhe bojlerëve për ngrohje qendrore
Lejohen	2529	Prodhimi i cisternave të tjera, rezervuarëve dhe mbajtësve prej metali
Lejohen	2530	Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç bojlerëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore
Lejohen	2540	Prodhimi i armëve dhe municioneve
Lejohen	2550	Farkëtimi, kovaçana, stampimi dhe petëzimi, pluhuri metalurgjik
Lejohen	2561	Trajtimi dhe veshja e metaleve
Lejohen	2562	Instrumentet
Lejohen	2571	Prodhimi i thikave
Lejohen	2572	Prodhimi i kyçeve dhe menteshave
Lejohen	2573	Prodhimi i veglave
Lejohen	2591	Prodhimi i kovave me çikrik prej çeliku dhe mbajtës të tjerë të ngjashëm
Lejohen	2592	Prodhimi i ambalazheve prej metali të lehtë
Lejohen	2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe sustë
Lejohen	2594	Prodhimi i dadove dhe bulonave
Lejohen	2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t
Lejohen	2611	Prodhimi i bazamenteve elektronikë
Lejohen	2612	Prodhimi i mbajtësve elektronike të loduar
Lejohen	2620	Prodhimi i kompjuterëve dhe pjesëve periferike
Lejohen	2630	Prodhimin e pajisjeve të komunikimit
Lejohen	2640	Prodhimi i produkteve elektronikave për konsumatorët
Lejohen	2651	Prodhimi i instrumenteve dhe aparateve për matje, verifikim, kontrolle
Lejohen	2652	Prodhimi i orëve dhe orëve të murit
Lejohen	2660	Prodhimi i pajisjeve rrezatuese, elektromjekësore dhe elektroterapiste
Lejohen	2670	Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve optike
Lejohen	2680	Prodhimi i mjeteve të komunikimit optike dhe magnetike
Lejohen	2711	Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve
Lejohen	2712	Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike
Lejohen	2720	Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve
Lejohen	2731	Prodhimi i kablove të fibrave optikë
Lejohen	2732	Prodhimi i telave dhe kablove të tjerë elektrike dhe elektronikë
Lejohen	2733	Prodhimi i telave transmetues
Lejohen	2740	Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit
Lejohen	2751	Prodhimi i aparateve shtëpiakë elektrike
Lejohen	2752	Prodhimi i pajisjeve shtëpiake jo-elektrike
Lejohen	2790	Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike
Lejohen	2811	Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç motorët e avionëve, automjeteve dhe motoçikleta
Lejohen	2812	Prodhimi i pajisjeve hidraulike
Lejohen	2813	Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë
Lejohen	2814	Prodhimi i tapave dhe valvulave
Lejohen	2815	Prodhimi i kushinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementët e drejtimit
Lejohen	2821	Prodhimi i furrave, furnaltave dhe aparaturave për djegie
Lejohen	2822	Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe zhvendosjes
Lejohen	2823	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve të zyrave, përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike
Lejohen	2824	Prodhimi i veglave portative me motor të inkomporuar
Lejohen	2825	Prodhimi i pajisjeve ftohëse dhe ventilese jo shtëpiake
Lejohen	2829	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.k.t.
Lejohen	2830	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore
Lejohen	2841	Prodhimi i instrumenteve për punimin e metaleve
Lejohen	2849	Prodhimi i instrumenteve të tjerë p.k.t.
Lejohen	2891	Prodhimi i makinerive për metalurgjinë
Lejohen	2892	Prodhimi i makinerive për industrinë nxjerrëse dhe ndërtim
Lejohen	2893	Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit
Lejohen	2894	Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstilëve, veshjeve dhe lëkurëve
Lejohen	2895	Prodhimi i makinerive për prodhimin e letës dhe kartonit
Lejohen	2896	Prodhimi i makinerive të plastikës dhe kauçikut
Lejohen	2899	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm p.k.t
Lejohen	2910	Prodhimi i mjeteve të transportit
Lejohen	2920	Prodhimi i karrocereve për mjetet e transportit: prodhimi i rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove
Lejohen	2931	Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet e transportit dhe motorët e tyre
Lejohen	2932	Prodhimi i pjesëve dhe aksesorëve të tjerë për mjetet e transportit dhe motorët e tyre



Lejohen	3011	Ndërtimi i anijeve dhe strukturave lundruese
Lejohen	3012	Ndërtimi i barkave të argëtimit dhe sportive
Lejohen	3020	Prodhimi i lokomotivave dhe mjetet mbështetëse të transportit hekurudhor
Lejohen	3030	Prodhimi i avionëve dhe pjesëve që lidhen me to
Lejohen	3040	Prodhimi i mjeteve luftarake të ushtrisë
Lejohen	3091	Prodhimi i motoçikletave
Lejohen	3092	Prodhimi i biçikletave dhe karrocave të invalidëve
Lejohen	3099	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit p.k.t.
Lejohen	3101	Prodhimi i mobilie të zyrave dhe dyqaneve
Lejohen	3102	Prodhimi i mobilie të kuzhinës
Lejohen	3103	Prodhimi i dyshekëve
Lejohen	3109	Prodhimi i mobilie të tjera
Lejohen	3211	Prerja e monedhave
Lejohen	3212	Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikuj të lidhur me to
Lejohen	3213	Prodhimi i stolive imitacion dhe artikuj të ngjashëm me to
Lejohen	3220	Prodhimi i instrumenteve muzikore
Lejohen	3230	Prodhimi i artikujve të sportit
Lejohen	3240	Prodhimi i lojërave dhe lodrave
Lejohen	3250	Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare
Lejohen	3291	Prodhimi i fshesave dhe furçave
Lejohen	3299	Industri të tjera p.k.t.
Lejohen	3311	Riparimi i produkteve metalike të fabrikua
Lejohen	3312	Riparimi i makinerive
Lejohen	3313	Riparimi i pajisjeve elektronike dhe optike
Lejohen	3314	Riparimi i pajisjeve elektrike
Lejohen	3315	Riparimi dhe mirëmbajtja e anijeve dhe barkave
Lejohen	3316	Riparimi dhe mirëmbajtja e avionëve dhe mjeteve të hapësirës
Lejohen	3317	Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera të transportit të p.k.t.
Lejohen	3319	Riparimi i pajisjeve të tjera p.k.t.
Lejohen	3320	Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale
Lejohen	3511	Prodhimi i energjisë elektrike
Lejohen	3512	Transmetimi i energjisë elektrike
Lejohen	3513	Shpërndarja e energjisë elektrike
Lejohen	3514	Tregtia e energjisë elektrike
Lejohen	3521	Prodhimi i gazit
Lejohen	3522	Shpërndarja e lëndëve djegëse të gazta nëpërmjet tubacioneve
Lejohen	3523	Tregtia e gazit nëpërmjet tubacioneve
Lejohen	3530	Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar
Lejohen	3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë
Lejohen	3700	Ujërat e zeza
Lejohen	3811	Grumbullimi i mbetjeve jo të rrezikshme
Lejohen	3812	Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme
Lejohen	3821	Trajtimi dhe heqja e mbetjeve jo të rrezikshme
Lejohen	3822	Trajtimi dhe heqja e mbetjeve të rrezikshme
Lejohen	3831	Çmontimi i pjesëve të shkatërruara
Lejohen	3832	Rikuperimi i materialeve
Lejohen	3900	Shërbime të tjera të pastrimit e të menaxhimit të mbetjeve
Lejohen	4110	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale
Lejohen	4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale
Lejohen	4211	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave
Lejohen	4212	Ndërtimi i hekurudhave mbi dhe nën tokësore
Lejohen	4213	Ndërtimi i urave dhe tuneleve
Lejohen	4221	Ndërtimi i veprave të tubacioneve e kanalizimeve
Lejohen	4222	Ndërtimi i veprave të shërbimit komunal për energjinë elektrike dhe telekomunikacione
Lejohen	4291	Ndërtimi i veprave ujore
Lejohen	4299	Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.t.k.
Lejohen	4311	Punime për prishje
Lejohen	4312	Përgatitja e kantierit të ndërtimit
Lejohen	4313	Shpime
Lejohen	4321	Instalime elektrike
Lejohen	4322	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit
Lejohen	4329	Instalime të tjera elektrike
Lejohen	4331	Punime suvatimi
Lejohen	4332	Punime montimi



Lejohen	4333	Punime për veshjen e dysHEMEVE dhe mureve
Lejohen	4334	Lyerja dhe vendosja e xhamave
Lejohen	4339	Punime të tjera përfundimtare dhe finicioni të ndërtesave
Lejohen	4391	Punime të çatisë
Lejohen	4399	Të tjera punime të specializuara ndërtimi
Lejohen	4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël
Lejohen	4519	Tregtia e automjeteve të tjerë
Lejohen	4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve (përfshirë gomisteritë)
Lejohen	4531	Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesoreve të automjeteve
Lejohen	4532	Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesoreve të automjeteve
Lejohen	4540	Shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve dhe aksesoreve të tyre
Lejohen	4611	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore si kafshëve të gjalla, lëndë e parë tekstile si dhe mallra gjysmë të gatshme
Lejohen	4612	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale
Lejohen	4613	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e lëndës drusore dhe materialeve të ndërtimit
Lejohen	4614	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e makinerive, pajisjeve industriale, anijeve dhe avionëve
Lejohen	4615	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e mobilieve mallrave shtëpiakë, artikuj elektronikë dhe hekurishte
Lejohen	4616	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, pelicëve, këpucëve, dhe artikujve prej lëkure
Lejohen	4617	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimorë, pijeve dhe duhanit
Lejohen	4618	Aktivitetet të ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçantë ose grupe produktesh p.k.t.
Lejohen	4619	Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e një varieteti mallrash
Lejohen	4621	Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve
Lejohen	4622	Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve
Lejohen	4623	Tregtia me shumicë e kafshëve
Lejohen	4624	Tregtia me shumicë e gëzofit të lëkurës
Lejohen	4631	Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve
Lejohen	4632	Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit
Lejohen	4633	Tregtia me shumicë e produkteve bulmetore, vezëve, dhe vajit të gatimit dhe yndyrave
Lejohen	4634	Tregtia me shumicë e pijeve.
Lejohen	4635	Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit
Lejohen	4636	Tregtia me shumicë e sheqerit dhe çokollatës dhe ëmbëlsirave
Lejohen	4637	Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave
Lejohen	4638	Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë të specializuar ushqimorë, përfshirë peshkun, krustacet dhe moluskët
Lejohen	4639	Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan
Lejohen	4641	Tregtia me shumicë e tekstileve
Lejohen	4642	Tregtia me shumicë e veshjeve dhe këpucëve
Lejohen	4643	Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake dhe radio e televizorë
Lejohen	4644	Tregtia me shumicë e porcelaneve, qelqurinave dhe lëndëve të pastrimit të tyre
Lejohen	4645	Tregtia me shumicë e artikujve të parfumerisë dhe kozmetikës
Lejohen	4646	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutike
Lejohen	4647	Tregtia me shumicë e mobilieve, qilimave dhe pajisjeve të ndriçimit
Lejohen	4648	Tregtia me shumicë e orëve dhe bizhuterive
Lejohen	4649	Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiakë
Lejohen	4651	Tregtia me shumicë e kompjuterëve, pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe programeve
Lejohen	4652	Tregtia me shumicë pajisjeve elektronike dhe të telekomunikacionit dhe pjesëve të tyre
Lejohen	4661	Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve
Lejohen	4662	Tregtia me shumicë e veglave të makinerive
Lejohen	4663	Tregtia me shumicë makinerive të minierave, ndërtimit, dhe për punime inxhinierike
Lejohen	4664	Tregtia me shumicë makinerive të industrisë tekstile dhe të makinerive qepëse e thurëse
Lejohen	4665	Tregtia me shumicë të mobilieve të zyrës
Lejohen	4666	Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrës
Lejohen	4669	Tregtia me shumicë e makinerive, pajisjeve dhe pjesëve p.k.t
Lejohen	4671	Tregtia me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to
Lejohen	4672	Tregtia me shumicë e metaleve dhe mineraleve
Lejohen	4673	Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare
Lejohen	4674	Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes dhe pjesëve të tyre
Lejohen	4675	Tregtia me shumicë e produkteve kimike
Lejohen	4676	Tregtia me shumicë e produkteve të tjerë ndërmjetës
Lejohen	4677	Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe skrapit
Lejohen	4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar
Lejohen	4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan
Mbyllen	4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara
Lejohen	4721	Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe prodhimeve të mishit në dyqane të specializuara



Lejohen	4723	Tregtia me pakicë të peshkut, krustaceve dhe molusqeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4724	Shitja me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve sheqeri në dyqane të specializuara (vetëm për <i>shërbim take away dhe delivery</i>)
Lejohen	4725	Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4726	Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuara
Lejohen	4729	Tregtia me pakicë të produkteve të tjera ushqimorë në dyqane të specializuara
Lejohen	4730	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuara
Lejohen	4741	Tregtia me pakicë e kompjuterëve, njësi periferike dhe softwear-ve në dyqane të specializuara
Mbyllen	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuara
Mbyllen	4743	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara
Mbyllen	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara
Lejohen	4752	Tregtia me pakicë e pjesëve elektronike, bojërave dhe xhamit në dyqane të specializuara
Mbyllen	4753	Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4754	Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara (Përveç makinave qepëse për përdorim shtëpiak)
Mbyllen	4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t
Lejohen	4761	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara
Lejohen	4762	Tregtia me pakicë e gazetave dhe artikujve shkrimorë në dyqane të specializuara
Mbyllen	4763	Tregtia me pakicë e regjistruarve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara
Mbyllen	4764	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara
Mbyllen	4765	Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara
Mbyllen	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara
Mbyllen	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara
Lejohen	4773	Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara
Lejohen	4774	Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjekësorë në dyqane të specializuara
Lejohen	4775	Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit në dyqane të specializuara
Mbyllen	4776	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara
Mbyllen	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara
Mbyllen	4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara (Përfshirë dhe “Tregtia me pakicë e Armëve dhe Municioneve, Artikujve Ushtarak”
Mbyllen	4779	Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane
Lejohen	4781	Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të produkteve ushqimorë, pijeve dhe duhanit
Mbyllen	4782	Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të tekstileve, veshjeve dhe këpucëve
Mbyllen	4789	Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të mallrave të tjera
Lejohen	4791	Tregtia me pakicë me porosi me <i>email</i> ose nëpërmjet internetit (Përfshihen shitjet përmes një demonstruesi ose një person i shitjeve)
Mbyllen	4799	Tregtia me pakicë të artikujve të tjerë jo në dyqane, tenda ose tregje
Mbyllen	4910	Transporti hekurudhor interurban i pasagjerëve
Lejohen	4920	Transporti hekurudhor i mallrave
Mbyllen	4931	Transporti rrugor i pasagjerëve me sistemin urban
Mbyllen	4932	Aktiviteti i taksive
Mbyllen	4939	Transporte të tjerë rrugor të pasagjerëve
Lejohen	4941	Transporti rrugor i mallrave
Lejohen	4942	Shërbime të lëvizshme
Lejohen	4950	Transporti me tubacion
Mbyllen	5010	Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve
Lejohen	5020	Transporti ujqor detar dhe bregdetar i mallrave
Lejohen	5030	Transporti ujqor i pasagjerëve në ujëra të brendshme
Lejohen	5040	Transporti ujqor i mallrave në ujëra të brendshme
Mbyllen	5110	Transporti ajror i pasagjerëve
Lejohen	5121	Transporti ajror i mallrave
Lejohen	5210	Magazinimi dhe ruajtja
Lejohen	5221	Shërbime të ndryshme ndaj transportit tokësor
Lejohen	5222	Shërbime të ndryshme ndaj transportit ujqor
Lejohen	5223	Shërbime të lidhura me transportin ajror
Lejohen	5224	Dorëzimi i ngarkesës
Lejohen	5229	Aktivitete të tjera mbështetëse të transportit
Lejohen	5310	Aktivitete të postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm
Lejohen	5320	Aktivitete të tjera postare dhe të korrierët
Lejohen	5510	Hotele dhe struktura të ngjashme
Lejohen	5520	Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive



Lejohen	5530	Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulotë argëtimi
Lejohen	5590	Akomodime të tjera
Lejohen	5610	Shërbim ushqimor i lëvizshëm
Lejohen	5621	Katering me porosi i cili duhet të shërbehet vetëm <i>take away</i> ose <i>delivery</i>
Lejohen	5629	Aktivitetet e shërbimeve ushqimore të tjera (përfshihen baret dhe restorantet dhe lejohen të gjitha subjektet të cilat tregtojnë ushqim të shpejtë (<i>fast food</i> ose byrektore) i cili duhet të shërbehet vetëm <i>take away</i> ose <i>delivery</i>)
Mbyllen	5630	Aktivitetet e shërbimit të pijeve (Bar, kafe dhe lokal)
Lejohen	5811	Publikimi i librave
Lejohen	5812	Publikimi i listave të adresave postare
Lejohen	5813	Publikimi i gazetave
Lejohen	5814	Publikimi i revistave dhe periodikëve
Lejohen	5819	Aktivitetet të tjera publikimi
Lejohen	5821	Publikimi i lojërave kompjuterike
Lejohen	5829	Publikimi i programeve të tjera
Lejohen	5911	Filma, video dhe aktivitete të prodhimit të programeve televizivë
Lejohen	5912	Post-produksioni i filmave kinematografi kë, të videove dhe programeve televizivë
Lejohen	5913	Aktivitetet të shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizivë
Lejohen	5914	Aktivitetet të projeksonit të filmave
Mbyllen	5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës
Lejohen	6010	Transmetimi i programeve radiofonike
Lejohen	6020	Aktivitetet të programacionit dhe transmetimit televiziv
Lejohen	6110	Aktivitetet të telekomunikacioneve (<i>wired</i>)
Lejohen	6120	Aktivitetet telekomunikacionit pa tel (<i>wireless</i>)
Lejohen	6130	Telekomunikacioni me satelit
Lejohen	6190	Aktivitetet të tjera të telekomunikacionit
Lejohen	6201	Aktivitetet të programimit informatik
Lejohen	6202	Aktivitetet të këshillimeve informatike
Lejohen	6203	Aktivitetet të menaxhimit të instalimeve informatike
Lejohen	6209	Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit
Lejohen	6311	Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse (<i>hosting</i>) të informacioni dhe aktivitete të lidhura me to
Lejohen	6312	Portat <i>web</i>
Lejohen	6391	Aktivitetet të agjencive të lajmeve
Lejohen	6399	Shërbime të tjera informacioni p.k.t
Lejohen	6411	Aktiviteti i bankës qendrore
Lejohen	6419	Ndërmjetësime të tjera financiare
Lejohen	6420	Aktivitetet të kompanive <i>holding</i>
Lejohen	6430	Truste, fonde dhe njësi të ngjashme financiare
Lejohen	6491	<i>Leasing</i> (Qiramarrja financiare)
Lejohen	6492	Aktivitetet të tjera garantimit të kredisë
Lejohen	6499	Ndërmjetësime të tjera financiare, përveç sigurimit dhe fondeve të pensionit, p.k.t
Lejohen	6511	Sigurimi i jetës
Lejohen	6512	Sigurime jo jetësore
Lejohen	6520	Risigurimi
Lejohen	6530	Financimi i Pensioneve
Lejohen	6611	Administimi i tregjeve financiare
Lejohen	6612	Aktivitetet sigurimit dhe kontratave të të mirave
Lejohen	6619	Aktivitetet ndihmëse të ndërmjetësimit financiar, përveç sigurimit dhe financimit pensioneve p.k.t
Lejohen	6621	Vlerësimi i riskut dhe dëmit
Lejohen	6622	Aktivitetet të agjentëve të sigurimit dhe komisionerëve
Lejohen	6629	Të tjera aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe financimit të pensioneve
Lejohen	6630	Menaxhimi i fondeve
Lejohen	6810	Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet
Lejohen	6820	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira (përfshihen qendrat tregtare)
Lejohen	6831	Agjencitë e pasurive të paluajtshme
Lejohen	6832	Menaxhimi i pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë
Lejohen	6910	Aktivitetet juridike
Lejohen	6920	Aktivitetet të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat
Lejohen	7010	Aktivitetet të drejtimit të ndërmarrjeve
Lejohen	7021	Aktivitetet të marrëdhënieve publike dhe të komunikimit
Lejohen	7022	Aktivitetet të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin
Lejohen	7111	Aktivitetet arkitekturore
Lejohen	7112	Aktivitetet inxhinierike dhe konsulencia teknike të lidhura me to
Lejohen	7120	Testimet dhe analizat teknike
Lejohen	7211	Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në bioteknologji



Lejohen	7219	Kërkime të tjera dhe zhvillime eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri
Lejohen	7220	Kërkime dhe zhvillime eksperimentale në shkencat shoqërore dhe humane
Lejohen	7311	Agjenci publiciteti
Lejohen	7312	Shërbime të përfaqësimit të mediave
Lejohen	7320	Studimi i tregut dhe sondazhet
Lejohen	7410	Aktivitete të specializuara skicimi
Lejohen	7420	Aktivitete fotografike
Lejohen	7430	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi
Lejohen	7490	Të tjera aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t
Lejohen	7500	Aktivitete Veterinare
Lejohen	7711	Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit
Lejohen	7712	Dhënia me qira dhe hua e kamionëve
Lejohen	7721	Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të kohës së lirë dhe mallra sportive
Lejohen	7722	Dhënia me qira e <i>video-tapes</i> dhe disqeve
Lejohen	7729	Dhënia me qira dhe hua e sendeve personale dhe e orendive shtëpiake të pa përfshira
Lejohen	7731	Dhënia me qira dhe hua e makinerive bujqësore dhe pajisjeve
Lejohen	7732	Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinierike
Lejohen	7733	Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përfshirë kompjuterët)
Lejohen	7734	Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të transportit të ujit
Lejohen	7735	Dhënia me qira dhe hua të pajisjeve të transportit ajror
Lejohen	7739	Dhënia me qira dhe hua të makinerive dhe pajisjeve të tjera dhe mallrave të prekshëm të pa përfshira
Lejohen	7740	Dhënia me qira e të mirave jo-financiare të patrupëzuara
Lejohen	7810	Aktivitete të agjencive të punësimit
Lejohen	7820	Agjenci të punësimit të përkohshëm
Lejohen	7830	Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore
Lejohen	7911	Aktivitete të agjencive të udhëtimit
Lejohen	7912	Aktivitete të operatorëve turistikë
Lejohen	7990	Të tjera aktivitete shërbimi për rezervim
Lejohen	8010	Aktivitete private sigurimi
Lejohen	8020	Aktivitete të shërbimeve të sigurimit
Lejohen	8030	Aktivitete hetimi
Lejohen	8110	Aktivitete të kombinuara për mbështetjen e strukturave
Lejohen	8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave
Lejohen	8122	Aktivitete të tjera pastrimi të ndërtesave dhe pastrimi i objekteve industriale
Lejohen	8129	Aktivitete të tjera pastrimi të pa përfshira
Lejohen	8130	Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve
Lejohen	8211	Aktivitete të kombinuara të shërbimit të administrimit të zyrave
Lejohen	8219	Fotokopjim, përgatitje dokumentesh dhe të tjera aktivitete mbështetëse të specializuara të zyrave
Lejohen	8220	Aktivitete të qendrave telefonike (<i>call center</i>)
Lejohen	8230	Organizatorë të konferencave dhe panairëve
Lejohen	8291	Aktivitete të agjencive të mbledhjes së dokumentacionit dhe zyra krediti
Lejohen	8292	Aktivitete paketimi
Lejohen	8299	Aktivitete të tjera shërbimi mbështetëse për bizneset p.k.t
Lejohen	8411	Aktivitete të administratës së përgjithshme publike
Lejohen	8412	Aktivitete të organizmave drejtuese për shëndetin, arsimimin, kulturën dhe të tjera shërbime sociale, përveç sigurimit social
Lejohen	8413	Aktivitete të organizmave drejtuese për aktivitetin ekonomik
Lejohen	8421	Punët e jashtme
Lejohen	8422	Aktivitete të mbrojtjes
Lejohen	8423	Drejtësi dhe aktivitete juridike
Lejohen	8424	Aktivitete të rendit publik dhe sigurimit
Lejohen	8425	Aktivitete shërbimi kundra zjarrit
Lejohen	8430	Aktivitete të sigurimi të detyrueshëm
Mbyllen	8510	Arsimi para shkollor
Mbyllen	8520	Arsimi fillor (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8531	Arsimi sekondar i përgjithshëm (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8532	Arsim i mesëm teknik dhe profesional (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8541	Arsimi pas të mesmes jo i lartë (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8542	Arsimi i lartë (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8551	Arsimi për sporte dhe argëtim (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8552	Arsim kulturor (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8553	Aktivitete të shkollave të drejtimit të mjeteve (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8559	Të tjera shkollime (përfshijet në mesimdhënia online)
Mbyllen	8560	Shërbime arsimore mbështetëse (përfshijet në mesimdhënia online)



Lejohen	8610	Aktivitetet e spitaleve
Lejohen	8621	Aktivitetet e mjekëve të përgjithshëm
Lejohen	8622	Aktivitetet e mjekëve të specializuar
Mbyllen	8623	Aktivitetet e dentistëve
Lejohen	8690	Të tjera aktivitetet e shëndetit
Lejohen	8710	Aktivitetet e qendrave të kujdesit infermieror
Lejohen	8720	Aktivitetet e qendrave të kujdesit për prapambetjet mendore, shëndetit mendor dhe abuzimit me substanca narkotike
Lejohen	8730	Aktivitetet e qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit dhe personave me paafësi
Lejohen	8790	Aktivitetet e qendrave të tjera të kujdesit p.k.t.
Lejohen	8810	Aktivitetet e kujdesit social pa akomodim për të moshuar dhe të paafët
Lejohen	8891	Aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijëve
Lejohen	8899	Aktivitetet e tjera të kujdesit sociale pa akomodim p.k.t.
Mbyllen	9001	Shfaqje artistike
Mbyllen	9002	Aktivitetet mbështetëse për shfaqje artistike
Mbyllen	9003	Krijimtari artistike
Mbyllen	9004	Shfrytëzimi i strukturave dhe pajisjeve artistike
Mbyllen	9101	Aktivitetet e bibliotekave dhe arkivave
Mbyllen	9102	Aktivitetet e Muzeve
Mbyllen	9103	Funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike të ngjashme tërheqëse për vizitorët
Mbyllen	9104	Kopshte botanike dhe zoologjike dhe aktivitetet e rezervatave natyrore
Mbyllen	9200	Aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve
Mbyllen	9311	Funksionimi i strukturave sportive
Mbyllen	9312	Aktivitetet e klubeve sportive
Mbyllen	9313	Palestra
Mbyllen	9319	Aktivitetet e tjera sportive
Mbyllen	9321	Aktivitetet e parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar
Mbyllen	9329	Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe çlodhëse p.k.t.
Lejohen	9411	Aktivitetet e shoqatave e organizimeve ekonomike dhe punëdhënësve
Lejohen	9412	Aktivitetet e shoqatave profesionale
Lejohen	9420	Aktivitetet e sindikatave të të punësuarve
Lejohen	9491	Aktivitetet e organizatave fetare
Lejohen	9492	Aktivitetet e organizatave politike
Lejohen	9499	Aktivitetet e organizatave të tjera p.k.t.
Lejohen	9511	Riparimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike
Lejohen	9512	Riparimi i pajisjeve të komunikimit
Lejohen	9521	Riparimi i pajisjeve elektronike të konsumit
Lejohen	9522	Riparimi i pajisjeve elektroshtëpiake dhe pajisjeve për shtëpi dhe të kopshtarisë
Lejohen	9523	Riparimi i këpucëve dhe artikujve prej lëkure
Lejohen	9524	Riparimi i mobilieve dhe orëdivë shtëpiake
Lejohen	9525	Riparimi i orëve, orëve të murit dhe bizhuterive
Lejohen	9529	Riparimi i artikujve personal dhe familjar p.k.t.
Lejohen	9601	Larja dhe pastrimi i tekstilëve dhe produkteve prej gëzofi
Mbyllen	9602	Flokët dhe trajtime të tjera të bukurisë
Lejohen	9603	Shërbime funerale dhe aktivitetet e lidhura me to
Mbyllen	9604	Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore
Mbyllen	9609	Aktivitetet e tjera p.k.t.
Lejohen	9700	Aktivitetet e familjeve si punëdhënës të personelit shtëpiak
Lejohen	9810	Aktivitetet e prodhimit të mallrave të pandryshueshme të familjeve për përdorim të vet
Lejohen	9820	Aktivitetet e prodhimit të shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorim të vet
Lejohen	9900	Aktivitetet e organizatave dhe organizmave ndërkombëtare



UDHËZUES

**PËR REKOMANDIME TË
PËRGJITHSHME NDAJ SUBJEKTEVE
TË BIZNESIT QË LEJOHEN TË
ZHVILLOJNË AKTIVITETIN NË
KUSHTET E LEHTËSIMIT TË MASAVE
TË MARRA PËR KUFIZIMIN E
PËRHAPJES SË COVID-19**

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të orientojë dhe t'ju rekomandojë punëdhënësve praktikatat e duhura të kufizimit të përhapjes së COVID-19 duke sjellë zvogëlimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve për të ruajtur vijimësinë e biznesit dhe krijimin e një ambienti pune të shëndetshëm.

Çdo subjekt duhet të respektojë masat e rekomanduara nga ISHP-ja, nëpërmjet një plani individual veprimi, duke respektuar çdo element për kufizimin e transmetimit të COVID-19 tek punonjësit brenda ambienteve të biznesit.

Zbatimi i këtij udhëzimi siguron:

1. Reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve;

2. Sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë;

3. Vijimësinë normale të aktivitetit të biznesit.

- Punëdhënësi është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshëm të elementeve të higjienës ku përfshihen sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli, që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim, letra dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve dhe sigurimi i koshave të mbyllur për eliminimin e mbetjeve.

- Punëdhënësi është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshëm të mjeteve të mbrojtjes personale si maska dhe doreza (maskat mund të jenë dhe prej cope dhe të ndërrohen çdo ditë). Punëdhënësi duhet të sigurojë përdorimin e maskave dhe dorezave si barrierë fizike për minimizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19.

- Punëdhënësi duhet të vendosë postera që inkurajojnë higjienën e duarve, për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes, në hyrje të vendit të punës dhe në zona të tjera të vendit të punës ku janë të dukshme.

- Punëdhënësi të rekomandojë që të mos përdoret shtrëngimi i duarve dhe përqafimet midis

punonjësve dhe inkurajojë përdorimin e metodave të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.

- Punëdhënësi duhet të hartojnë politika të brendshme të subjektit, siç janë mundësim të punës nga shtëpia ose orë *flexibile*, të cilat lejojnë të rritet distanca fizike nga një punonjës në tjetrin ose/dhe krijojnë mundësinë e këtyre punonjësve të jenë në distancë 2 metra nga njëri-tjetri.

- Punonjësve t'ju kërkohet të aplikojnë larjen e duarve ose përdorimin e dezinfektantëve kur ato janë të ndotura ose pas heqjes së maskës dhe dorezave. (Mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së mbi hapat dhe mënyrën e larjes së duarve)

- Punëdhënësi nuk duhet të lejojë punonjësit e tyre të përdorin mjetet e njeri-tjetrit dhe postet e ndërsjella të punës.

- Punëdhënësi duhet të nxisin punonjësit e tyre për respektimin e praktikave të etikës respiratore, kollitjes e teshtitjes duke përdorur vënien e gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës.

- Punonjësit duhet të respektojnë masat e distancimit social të cilat do të kryhen sipas një plani të vetë bizneseve dhe të theksohet nëse kapaciteti i punëtorëve kalon për sipërfaqe në m², duke respektuar distancën 2 m, bizneset të punojnë në dy turne sipas orarit të lejuar.

- Punëdhënësi duhet të inkurajojë:

- zbatimin e vendeve të punës fleksibël (p.sh: punë në distancë);

- zbatimin e orëve fleksibël të punës (p.sh: ndërrime të orarit të punës);

- rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve në vendin e punës;

- rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve dhe klientëve (p.sh: përmes ndarjeve)

- zbatimin e opsioneve fleksibël të takimit dhe udhëtimit (p.sh: shtyrja e takimeve ose ngjarjeve jo thelbësore);

- uljen e disa shërbimeve apo produkteve;

- ofrimin e shërbimeve nga distanca (p.sh: telefon, video ose *web*);

- dorëzimin e produkteve përmes marrjes në dorëzim sipas një plani dhe duke siguruar distancat përkatëse.

- Bizneset duhet të praktikojnë pastrimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës si p.sh: stacionet e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Është e nevojshme që produktet dezinfektante të kenë përqindjen, metodën e aplikimit dhe kohën e



kontaktit të saktë, si dhe përdorimi i tyre duhet bërë duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale. (Mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së për pastrimin e mjedisit në objektet (jo të kujdesit shëndetësor) të ekspozuar ndaj Covid-19)

- Nëse sipërfaqet janë të ndotura, ato duhet të pastrohen duke përdorur një pastrues ose sapun dhe ujë para dezinfektimit.

- Për dezinfektim mund të përdoren dezinfektuesit shtëpiak më të zakonshëm, si dhe të tjerë sipas udhëzimeve të MSHMS-së. Ndiqni udhëzimet e prodhuesit për të gjitha produktet e pastrimit dhe dezinfektimit (p.sh: përqendrimi, metoda e aplikimit dhe koha e kontaktit, etj).

- Punëdhënësit duhet të këshillojnë punëtorët që të mos përdorin telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punëtorëve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, të pastrohen dhe dezinfektohen ato para dhe pas përdorimit. Gjithashtu duhet të sigurohen pastruesit e mundshëm në mënyrë që sipërfaqet e përdorura zakonisht (për shembull telekomandat, tastierat mjetet dhe pajisjet e tjera të punës etj) mund të fshihen nga punonjësit para çdo përdorimi.

- Çdo punonjës është i detyruar të deklarojë në biznesin apo ndërmarrjen ku është punësuar nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë me Covid-19.

- Nëse në një subjekt, një nga punonjësit është apo ka pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv Covid-19 duhet të qëndrojnë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë mjekun e biznesit dhe administratorin, i cili më pas njofton NJVKSH-në përkatëse.

- Punonjësit që kanë shenja klinike të qëndrojnë në shtëpi, të vetëizolohen dhe të monitorojnë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojnë 127 dhe mjekun e familjes, si dhe të njoftojnë mjekun e biznesit dhe administratorin.

- Administratori i subjektit duhet të largojë punonjësin nga puna për të qëndruar në shtëpi nëse ai shfaq shenja klinike dhe duhet të njoftojë menjëherë brenda 24 orëve NJVKSH-në dhe ISHP-në.

- Nëse ka një rast të dyshuar me Covid-19 nga mjeku i biznesit apo ndërmarrjes, duhet të njoftohet menjëherë NJVKSH-ja dhe ISHP-ja.

- Të minimizohet kontakti midis klientëve dhe punonjësve duke i zëvendësuar takimet fizike me komunikime *online*.

- Administratorët e bizneseve duhet të vendosin elementët e distancimit fizik me shenja vizuale të dukshme në sipërfaqen e dyshemesë, si dhe rregullorja mbi tërësinë e masave të minimizimit të transmetimit të COVID-19 të jetë e afishuar në mënyrë sa më të dukshme.

- Çdo biznes duhet të ketë një mjedis të caktuar të izoluar një punonjës, i cili mund të shfaq shenja klinike të sëmundjes dhe më pas lajmërohet 127-ta dhe NJVKSH-ja përkatëse.

- Çdo biznes që ka më shumë se 5 persona rekomandohet të vendosë kamera të survejancës, për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjienës dhe kujdesit zbatohen me saktësi.

- Distancimi social do të kryhet sipas një plani të vetë bizneseve për fasoneri, rrobaqepësi, *call center* etj., dhe nëse kapaciteti i punëtorëve kalon normën e lejuar për sipërfaqe në m² duke respektuar distancën 2 m, bizneset të punojnë në dy turne sipas orarit të lejuar, duke pasur të gjitha kushtet për të kryer dezinfektimin dhe duke përdorur maskat dhe dorezat në mënyrë të detyrueshme.

- Të konsiderohen përmirësimi i kontroleve inxhinierike duke përdorur sistemin e ventilimit të ndërtesave. Kjo mund të përfshijë disa ose të gjitha aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e niveleve të ventilimit;

- rritja përqindjes së ajrit në natyrë që qarkullon në sistem.

Mbështetur në nivelet e riskut, nga niveli jeshil deri në nivelin e kuq, për transmetimin e infeksionit COVID-19, të gjithë subjektet që janë në nivelin jeshil duhet të përdorin dorezat, maskat mbrojtëse. Respektimi i distancës 2 m, vendosja e shenjave të pritjes në radhë, afishimi i mundësisë së blerjeve *online*, rezervimi i takimit *online* apo me telefon, vendosja e xhamit mbrojtës i klientit shitës, dezinfektim i ambientit, larje para hapjes dhe pas mbylljes sidomos i tavolinave, banakëve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka pasur kontakt me duar, ajrimi sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë.

Në nivelin portokalli dhe të kuq do të kërkohet frekuencë e shtuar e ajrimit, dezinfektim me tunel *spray* në hyrje dhe në dalje të biznesit për të gjithë punonjësit. (Mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së për pastrimin e mjedisit në objektet (jo të kujdesit shëndetësor) të ekspozuar ndaj Covid-19)

- ISHSH-ja duhet të kryejë inspektimin sistematik për vlerësimin e zbatimit të masave përkundrejt penaliteteve në fuqi.



- Bizneset duhet të jenë të përgatitura që vlerësimi në mënyrë sistematike i situatës epidemiologjike (ritje e rasteve pozitive, shtim i rasteve të hospitalizuara etj.) do të sjellë për pasojë rishtrëngim të masave të lejuara.

DREJTOR
Albana Fico

URDHËR
Nr. 263, datë 17.4.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË
LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE
KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR,
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN
E MJETEVE PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Lejohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë, ditën e shtunë, datë 18.4.2020, deri në orën 11.00, të shoqëruar me jo më shumë se një person në krah.

2. Duke filluar nga dita e hënë, datë 20.4.2020, qytetarët/të sëmurët kronikë, që lëvizin për trajtime mjekësore, të vërtetuar me kopje të dokumentacionit të strukturës shëndetësore dhe që marrin shërbim shëndetësor në spitale (sipas rregullave të përcaktuara për periudhën e epidemisë), apo shoqëruesit e tyre, duhet të vetëdeklarojnë në portalin *e-Albania*, duke përcaktuar orarin e lëvizjes, itinerarin me destinacionin përkatës, si dhe të dhënat e mjetit, në rastet kur lëvizja kryhet me të.

3. Duke filluar nga dita e hënë, datë 20.4.2020, lejohet lëvizja me mjete private, sipas autorizimit përkatës, e të gjithë personave të cilët janë në marrëdhënie pune në një nga veprimtaritë e lejuara, në fashat orare të përcaktuara ose sipas orarit të

diktuar nga natyra e punës dhe të paralajmëruara, vetëm për itinerarin shtëpi–punë dhe anasjelltas, pa ndalesa të ndërmjetme.

4. Personat e lejuar të lëvizin me mjete private, sipas pikës 3, të këtij urdhri, lejohen që të marrin vetëm një pasagjer familjar me autorizim pune ose një koleg nga i njëjti vend pune, i cili duhet të ulët në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit.

5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 263/1, datë 18.4.2020

**PËR DISA SHTESA NË URDHRIN NR.
263, DATË 17.4.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË
LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE
KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN
ME MJETE PRIVATE”,**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 263, datë 17.4.2020, “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen me mjete private”, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e urdhrit, pas fjalës “...pensionistë...”, shtohen fjalët “...nënat me fëmijë...”.



2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Lejohet lëvizja e nënave me fëmijë deri në moshën 10 (dhjetë) vjeç, ditën e diel, datë 19.4.2020, deri në orën 11:00, të pashoqëruar me persona të tjerë në krah.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 273, datë 24.4.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR. 263, DATË 17.4.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË
LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE
KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN
E MJETEVE PRIVATE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 263, datë 17.4.2020, “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen me mjete private”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “ditën e shtunë datë 18.4.2020” zëvendësohet me togfjalëshin “ditën e shtunë datë 25.4.2020”.

2. Në pikën 1/1, togfjalëshi “ditën e diel, datë 19.4.2020” zëvendësohet me togfjalëshin “ditën e diel, datë 26.4.2020”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 278, datë 25.4.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020,
“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Në pikën 1/1, togfjalëshi “afat prej 90 minutash” zëvendësohet me togfjalëshin “afat prej 2 (dy) orësh”.

2. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtje si vijon:

“3/1 Lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të kategorizuara me risk të ulët sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga dita e hënë, datë 27.4.2020, e në vijim, në intervalin kohor prej orës 5:00, deri në orën 17:30. Këto aktivitete do të ushtrojnë veprimtarinë vetëm në bazë të protokolleve të miratuara në urdhrin nr. 266, datë 21.4.2020, “Për përcaktimin e kategorive të bizneseve sipas niveleve të riskut dhe miratimit të protokolleve të masave higjieno-sanitare dhe distancimit social për parandalimin e përhapjes së COVID-19”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



Statusi	Klasa	Klasa _ Përshkrimi
Lejohen	4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara.
Lejohen	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara.
Lejohen	4932	Aktiviteti i taksive.
Lejohen	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara.
Lejohen	9609	Aktivitete të tjera p.k.t.
Lejohen	4759	Tregtia me pakicë e mobilie, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t.
Lejohen	4776	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara.
Lejohen	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara.
Lejohen	4743	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara.
Lejohen	5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës.
Lejohen	4753	Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4765	Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara.
Lejohen	4763	Tregtia me pakicë e regjistruarve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara.
Lejohen	4764	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara.
Lejohen	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuara/pajisjet e telekomunikacionit në dyqane të specializuara.

URDHËR

Nr. 279, datë 25.4.2020

PËR LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, vendimit të Komitetit Teknik nr. 1892/1, datë 24.4.2020,

URDHËROJ:

1. Caktimin e qarkut Dibër, qarkut Gjirokastrë, zonës së përbashkët të bashkive Sarandë, Konispol, Himarë, Delvinë dhe Finiq, zonës së përbashkët të bashkive Përrenjas, Pogradec dhe Librazhd dhe Bashkia Divjakë si “zona të gjelbërta”, apo zona me rrezik të ulët të transmetimit të infeksionit nga COVID-19.

2. Në zonat e gjelbërta, pensionistët do të lëvizin lirisht në këmbë nga ora 06:00 deri në orën 08:30 dhe gjatë kësaj kohe nuk do të lejohet lëvizja e asnjë këmbësori tjetër, përveç atyre që kanë autorizim për punë.

3. Nga ora 09:30 deri në orën 17:30 lejohet të lëvizin, me jo më shumë se me një person në krah, të gjithë këmbësorët e tjerë. Përtej këtij orari

lejohen të lëvizin vetë, këmbësorët që kanë autorizim pune, të cilët lëvizin sipas orarit të diktuar nga natyra e punës.

4. Ndalohet lëvizja dhe qëndrimi në një vend i më shumë se dy personave. Parqet publike dhe hapësirat e gjelbërta të rrethuara do të vazhdojnë të jenë të mbyllura edhe në këto zona për 14 ditë.

5. Mjetet e transportit të punonjësve në institucionet publike dhe/ose private do të lejohen të lëvizin me autorizimin përkatës, sipas orarit të diktuar nga natyra e punës vetëm me një pasagjer i cili duhet të ulët në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit, sipas protokolleve të miratuara.

6. Lejohet lëvizja e mjeteve private, pa autorizim, vetëm brenda qarkut ose bashkive përkatëse nga ora 09:30 deri 17:30, vetëm me një pasagjer në automjet, i cili duhet të ulët në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit, sipas protokolleve të miratuara.

7. Ndalohet lëvizja e pensionisteve me mjete private ose marrja e tyre si pasagjerë me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



VENDIM
Nr. 48, datë 24.3.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLARIS
POWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1 dhe 3, 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.3.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447 prot., datë 17.2.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 13.6.2019, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

- Objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. ka tregtimin e energjisë.

- Aplikimi i shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti, si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- formati i aplikimit sipas kërkesave të pikës “a”, “b” dhe “c” të këtij neni është plotësuar pjesërisht;

- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit).

Për sa i takon përfaqësuesit ligjor, shoqëria ka përcjellë në ERE prokurën e posaçme në formatin fotokopje, ndaj do t’i kërkohej që të sjellë këtë akt përfaqësimi sipas formës së përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores së licencimit.

Neni 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria)

Në aplikimin e bërë nga shoqëria mungon vërtetimi i prokurorisë për administratorin e shoqërisë, si dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin ligjor. Ky dokumentacion do t’i kërkohej shoqërisë të depozitohet në ERE jo me vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.

- germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse).

Shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t’i kërkohej plotësimi i këtij dokumentacioni.

Neni 9, pika 3: Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të



aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit)

Shoqëria nuk ka përcjellë dokumentacion që vërteton aftësinë ose mbështetjen financiare të tij për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Do t'i kërkohej shoqërisë të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës.

Neni 9, pika 4.8: Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike

- germa "a": Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në GWh sipas viteve

Shoqëria nuk ka paraqitur parashikime të tilla, ndaj do t'i kërkohej të depozitojë këtë informacion në ERE.

- germa "b": Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. Shoqëria nuk ka paraqitur të dhëna në lidhje me kapitalin financiar, ndaj do t'i kërkohej të paraqesë në ERE dokumentacionin e nevojshëm për këtë kërkesë të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Solaris Power" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Subjekti aplikues ka detyrimin për të paraqitur, jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, germa d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe

mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 49, datë 24.3.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË "GREEN ENERGY
TRADING ALBANIA" SHPK, NR. 286,
SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s
NR. 59, DATË 23.4.2015**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 24.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 432 prot., datë 13.2.2020, mbërritur në drejtori në datën 20.2.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.



- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Në datën 25.9.2014, është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42125016S.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Konstatohet se shoqëria “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo jo të plotë, që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 2

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësor

- germa “c” (Vërtetimi i regjistrimit dhe ekstrakt historik nga QKB-ja):

- do t’i kërkohet shoqërisë ta plotësojë vërtetimin e regjistrimit pranë QKB-së, në zbatim të kësaj kërkesë të rregullores.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë):

- do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për administratorin e shoqërisë dhe përfaqësuesin e saj ligjor, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 16, pika 1, germa “c”

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3

Neni 9, pika 3

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime)):

- në vijim do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE edhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Neni 9, pika 4.8

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie):

Në vijim do t’i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije ERE-n, lidhur me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë nr. 286, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.4.2020.

2. Subjekti aplikues ka detyrimin për të paraqitur, jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, germa d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,



rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 52, datë 26.3.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY
ALBANIA” SHPK, NR. 290, SERIA T15,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s,
NR. 72, DATË 13.5.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; vendimit nr. 51, datë 26.3.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në

mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me rinovimin e licencës nr. 290, seria T15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 552, datë 4.3.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës nr. 290, seria T15 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 290, seria T15, të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 72, datë 13.5.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 13.5.2020.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti mund të bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi për rinovim është kryer në datën 4.3.2020, brenda afatit të parashikuar në rregulloren për rinovimin e licencës së tregtimit.

- Rezulton se shoqëria ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar rezulton si më poshtë:

- Neni 16, pika 1, germa “a”- Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 16, pika 1, germa “b”- Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”/“b”, germa “c”, germa “d”, germa “e”. Plotësuar pjesërisht.

- Neni 16, pika 1, germa “c” - Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, germa



“a”, germa “b”, germa “c”, germa “d”. Plotësuar pjesërisht.

- Neni 16, pika 1, germa “d” - Çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike. Plotësuar pjesërisht.

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore,

Neni 9, pika 2:

- germat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti). Plotësuar pjesërisht;

Nuk është depozituar Statuti i shoqërisë dhe pas fillimit të procedurës do t’i kërkohej shoqërisë, ta paraqesë atë në ERE.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht,

Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për të tre administratorët e saj dhe për vetë shoqërinë jo me vonë se afatet e parashikuara në vendimin nr. 51, datë 26.3.2020, të Bordit të ERE “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”,

- germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht;

Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë, të paraqesë strukturën organizative të saj në gjuhën Shqipe dhe listën e personelit sipas profilit.

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3,

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave, dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Plotësuar pjesërisht.

Shoqërisë do t’i kërkohej të depozitojë në ERE, Vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Plotësuar pjesërisht. Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë, të paraqesë në ERE, gjendjen e llogarisë bankare që disponon në cilësinë e dokumentacionit që vërteton mbështetjen e tij financiare.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e Tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 4.8:

- germat “a”/ (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve); Pa plotësuar.

- germa “b” Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie). Pa plotësuar.

- germa “c” (Lista e kontratave të mëparshme të realizuara, nëse ka pasur). Pa plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nenit 10 dhe 11, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

- Me vendimin nr. 51, datë 26.3.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur:

- Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe nenit 9, pika 1, germa d, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

- Subjektet e licencuar gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t’i paraqitur jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19 vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 290, seria T15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 72, datë 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Aplikuesi të bëjë me dije në lidhje me ushtrimin e së drejtës së aplikimit të kushteve të



parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 53, datë 26.3.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY
ALBANIA” SHPK, NR. 291, SERIA FK15,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s,
NR. 73, DATË 13.5.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”, nenit 10, pika 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; vendimit nr. 51, datë 26.3.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi

Faqe| 4392

relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me rinovimin e licencës nr. 291, seria F15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 552, datë 4.3.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 291, seria FK15, të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 73, datë 13.5.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 13.5.2020.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi për rinovimin e licencës së furnizimit rezulton se është kryer brenda afatit të parashikuar në rregullore.

- Rezulton se aplikuesi ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Dokumentacioni i aplikimit rezulton kryesisht i plotësuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Neni 16, pika 1, germa “a”- Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 16, pika 1, germa “b”- Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, gjerat: “a”/“b”, germa “c”, germa “d”, germa “e”. Plotësuar pjesërisht.

- Neni 16, pika 1, germa “c”- Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, germa



“a”, germa “b”, germa “c”, germa “d”. Plotësuar pjesërisht.

- Neni 16, pika 1, germa “d” - Çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike. Plotësuar pjesërisht;

- Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore

Neni 9, pika 2:

- germat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti). Plotësuar pjesërisht;

Nuk është depozituar Statuti i shoqërisë dhe pas fillimit të procedurës do t’i kërkohej shoqërisë, ta paraqesë atë në ERE.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht.

Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për të tre administratorët e saj dhe për vetë shoqërinë, jo më vonë se afatet e parashikuara në vendimin nr. 51, datë 26.3.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë.

- germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht;

Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë, të paraqesë strukturën organizative të saj në gjuhën Shqipe dhe listën e personelit sipas profilit.

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3,

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave, dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. Plotësuar pjesërisht.

Shoqërisë do t’i kërkohej të depozitojë në ERE, Vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), Plotësuar pjesërisht. Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 4.7:

- germat “a”/ (të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve, subjekti, central prodhues, sasia e energjisë kontraktuar, në GWh sipas viteve); Pa plotësuar.

- germa “b” Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. Pa plotësuar.

- germa “c” Lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme/nëse ka, për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike. Pa plotësuar.

- germa “d”. Informacion i detajuar tekniko-financiar, lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave. Pa plotësuar.

- germa “e”, sistemin IT, të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorim të këtij shërbimi. Pa plotësuar,

- germa “g”. Dokumentacioni që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizimit për shërbimet që do t’i afrohen klientëve. Pa plotësuar.

- germa “h” të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar. (kategoritë, nënkategoritë, numri i konsumatorëve, sasia e energjisë në GWh në vitin e (I, II, III, IV dhe V), lidhja në Un, Fuqia e instaluar e konsumatorëve, aktiviteti(familjarë, buxhetorë, privatë). Pa plotësuar.

- germa “i”. Niveli i nënstacionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët. Pa plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nenit 10 dhe 11, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

- Me vendimin nr. 51, datë 26.3.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur:

- Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe nenit 9, pika 1, germa d, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në



sektorin e gazit natyror” miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

- Subjektet e licencuar gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t'i paraqitur, jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 291, seria F15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Aplikuesi të bëjë me dije në lidhje me ushtrimin e së drejtës së aplikimit të kushteve të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 54, datë 26.3.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 141, DATË 24.9.2019, MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shfuqizimin e pjesshëm të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.9.2019, për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe nr. 141, datë 24.9.2019, mbi licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 141, datë 24.9.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur në pikën 2: të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kusht që të depozitojë në ERE vërtetimin për përfundimin e procedurës së apelimit për detyrimin e TVSH-së, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 520 prot., datë 24.2.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.

- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 014 prot., datë 28.2.2020, protokolluar në ERE me nr. 520/1 prot., datë 2.3.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar në ERE shkresën nr. 1481/1 prot., datë 26.2.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, drejtuar shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., nga e cila rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pa likuiduara për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.



- Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 141, datë 24.9.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 141, datë 24.9.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) pika 2, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palën e interesit lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 55, datë 26.3.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 142, DATË 24.9.2019, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pjesshëm të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 142, datë 24.9.2019, për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe nr. 141, datë

24. 9.2019, mbi licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 142, datë 24.9.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur në pikën 2: Të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kusht që të depozitojë në ERE vërtetimin për përfundimin e procedurës së apelimit për detyrimin e TVSH-së, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme

- Në vijim të këtyre vendimmarrjeve, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 520 prot., datë 24.2.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.

- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 014 prot., datë 28.2.2020, protokolluar në ERE me nr. 520/1 prot., datë 2.3.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar në ERE shkresën nr. 1481/1 prot., datë 26.2.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, nga e cila rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pa likuiduara për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

- Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.9.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.9.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) pika 2, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palën e interesit lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 56, datë 26.3.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 228, DATË 26.10.2018, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “OSOJA HPP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “OSOJE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1952 kw, NË ZONËN E MOGLICËS –KORÇË (LUMI OSOJË)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 228, datë 26.10.2018, për licencimin e shoqërisë ‘Osoja HPP’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Osoje’, me kapacitet të instaluar 1952 kW, në zonën e Moglicës–Korçë (Lumi Osojë)”,

konstatoi se:

Me vendimin nr. 228, datë 26.10.2018, Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoja” me fuqi 1952 kw, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës-Korçë (Lumi Osojë) për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçarë).

2. Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., duhet të përcjellë në ERE, ndryshimin e kontratës me nr. 1755 rep., nr. 776/3 kol., datë 25.7.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osojë”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 529, datë 26.2.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.

- Shoqëria, me shkresën nr. 10 prot., datë 4.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 529/1 prot., datë 6.3.2020, ka depozituar në ERE dokumentacionin si vijon:

- Kopje kontrate me nr. 2255 rep., nr. 1106/2 kol., datë 26.10.2018, të lidhur me palët: MIE dhe shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k.: Për amendim kontratën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit Osojë, me kapacitet prodhues 1.952 kW, në lumin e Osojës, degë e lumit Devoll, në Bashkinë Korçë, qarku Korçë, me nr. 1755 rep., nr. 776/3 kol., datë 25.7.2017, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive: “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “Osoja Energy” sh.p.k., me përfaqësues shoqërinë “Favina”, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osoje” me kapacitet prodhues 1952 kw, në lumin e Osojës, degë e lumit Devoll, në Bashkinë Korçë, qarku Korçë.

- Në nenin 2 të kontratës sipërcituar është parashikuar se: Kudo në kontratë togfjalëshi: “Bashkimi i përkohshëm i shoqërive ‘Favina’ sh.p.k., ‘Osoja Energy’ sh.p.k. dhe ‘Fava 1’ sh.p.k.”, zëvendësohet me togfjalëshin: Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k.

- Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k. rezulton të ketë plotësuar detyrimin e parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 228, datë 26.10.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 228, datë 26.10.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Osoja HPP’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Osoja’ me fuqi 1952 kW, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës-Korçë, (lumi Osojë)”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) pika 2 shfuqizohet

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 57, datë 26.3.2020**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 72, DATË
10.5.2019, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘SMART WATT’ SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw,
NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA
ADMINISTRATIVE TOPOJË,
BASHKIA FIER”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.5.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Smart Watt’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 72, datë 10.5.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me fuqi të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Para vënies në punë të centralit, shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., të depozitojë në ERE miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit apo shpërndarjes.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 514, datë 24.2.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.

- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 21 prot., datë 27.2.2020, protokolluar në ERE me nr. 514/1 prot., datë 26.2.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar në ERE dokumentacionin si vijon:

- Preventivin nr. 17090 prot., datë 6.8.2019, të OSHEE-së, “Për miratim pikë lidhje për centralin fotovoltaik ‘Smart Watt’”.

- Shkresën nr. 17090/1 prot., datë 18.11.2019, të OSHEE-së drejtuar shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., “Ofertë për lidhjen e burimit të ri gjenerues në rrjetin shpërndarës”.

- Shkresën nr. extra prot., datë 19.11.2019, të shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., drejtuar OSHEE-së, “Pranim i ofertës për lidhjen e burimit të ri gjenerues në rrjetin OSHEE”.

- Marrëveshjen e lidhjes së re, me nr. 17090/2 prot., datë 19.11.2019, të lidhur mes OSHEE-së dhe shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., me objekt lidhjen e burimit gjenerues në rrjetin e shpërndarjes, me adresë Sheq Marinas, Topojë, Fier.

- Shkresën nr. 17090/3 prot., datë 20.11.2019, të OSHEE-së, drejtuar shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., për dijeni Drejtorisë së Tensionit të Lartë, “Miratim pikë lidhje central fotovoltaik”, nëpërmjet së cilës miratohet lidhja e centralit fotovoltaik të shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 35 kV, të nënstacionit Hoxharë 35/10 kV.

Rezulton se shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., ka depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.5.2019, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në vendimin e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI :

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.5.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Smart Watt’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier” bëhet ndryshimi, si më poshtë:

a) pika 2 shfuqizohet.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palën e interesit dhe OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë